REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM

Nr. 656 prot. Tiranë, më 27.03.2026

Lënda: Dërgim i raportit të përgjithshëm të inspektimeve për vitin 2025.

Z. EDI RAMA
KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I nderuar z. Rama,

Inspektorati i Përgjithshëm, në zbatim të Ligjit nr. 99, datë 12.09.2025, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të VKM nr. 330, datë 16.08.2013, "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratin e Përgjithshëm", bashkëlidhur po ju dërgon raportin e përgjithshëm të inspektimeve për vitin 2025.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Dashnor Sula

REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM

[redacted]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI PËRGJITHSHËM

Mesazhi i Inspektorit të Përgjithshëm

Të nderuar!

Raporti që keni në duar nuk është thjesht një përmbledhje shifrash apo një dokument teknik mbi veprimtarinë e një viti. Ai është pasqyrimi i një transformimi të thellë që po kalon sistemi i inspektimeve në Republikën e Shqipërisë – një transformim që prek drejtpërdrejt marrëdhënien mes shtetit, biznesit dhe qytetarit.

Viti 2025 shënoi një moment kyç në këtë rrugëtim. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", nisi një fazë e re: kalimi nga një model tradicional kontrolli, shpesh i fragmentuar dhe reaktiv, drejt një sistemi të unifikuar, të bazuar në analiza risku, në transparencë dhe mbi të gjitha në parandalim. Ky ndryshim nuk është vetëm teknik; ai përfaqëson një filozofi të re qeverisjeje, ku qëllimi nuk është ndëshkimi, por garantimi i respektimit të ligjit përmes ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit.

Gjatë këtij viti, Inspektorati i Përgjithshëm ka luajtur një rol themelor në jetësimin e kësaj reforme. Janë hedhur themelet rregullatore përmes miratimit të akteve nënligjore, është avancuar standardizimi i procedurave dhe dokumentacionit, si dhe është forcuar roli metodologjik dhe koordinues në raport me të gjitha trupat inspektuese. Në të njëjtën kohë, është investuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore, përmes trajnimit të qindra inspektorëve dhe formalizimit të mëtejshëm të statusit të tyre profesional.

Një nga shtyllat kryesore të këtij transformimi ka qenë dixhitalizimi. Sistemi elektronik "e-Inspektimi" ka shërbyer si një platformë kyçe për rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe standardizimit të procesit inspektues. Edhe pse gjatë vitit janë hasur vështirësi teknike që kanë ndikuar përkohësisht në funksionimin e tij, angazhimi për modernizimin dhe konsolidimin e këtij sistemi mbetet i palëkundur. Sepse një sistem inspektimi modern nuk mund të ekzistojë pa një infrastrukturë teknologjike të qëndrueshme dhe efikase.

Rezultatet e këtij viti tregojnë qartë drejtimin e duhur të reformës. Ulja e ndjeshme e masave administrative ndëshkuese, në veçanti e gjobave, nuk është tregues i dobësimit të kontrollit, por i ndryshimit të qasjes: nga ndëshkimi drejt korrigjimit dhe parandalimit. Paralajmërimi si masë e

parë ka krijuar hapësirë për reflektim dhe përmirësim nga subjektet, duke ulur barrën administrative dhe duke rritur bashkëpunimin me institucionet.

Po ashtu, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies, përmes trajtimit të ankesave, ngritjes së mekanizmave të rinj si Komisionet e Shqyrtimit të Ankimit dhe përditësimit të instrumenteve të komunikimit me publikun. Këto mekanizma janë thelbësorë për të garantuar që çdo vendimmarrje të jetë e drejtë, e arsyetuar dhe e kontrollueshme.

Megjithatë, ky raport nuk synon të paraqesë vetëm arritjet. Ai reflekton me realizëm edhe sfidat që kemi përpara. Harmonizimi i plotë i legjislacionit sektorial, përshtatja e strukturave organizative me modelin e ri, forcimi i kapaciteteve profesionale dhe analitike, si dhe garantimi i funksionimit të plotë të sistemeve dixhitale janë ndër prioritetet që kërkojnë vëmendje të menjëhershme.

Po aq e rëndësishme mbetet edhe konsolidimi i kulturës institucionale. Reforma nuk është vetëm çështje rregullash apo sistemesh; ajo është mbi të gjitha çështje mentaliteti. Kërkon që çdo inspektor, çdo institucion dhe çdo aktor i përfshirë të ndajë të njëjtin standard përgjegjshmërie, të njëjtën qasje profesionale dhe të njëjtin angazhim ndaj interesit publik.

Vizioni ynë është i qartë: ndërtimi i një sistemi inspektimi të unifikuar në të gjithë territorin e vendit, ku çdo procedurë ndiqet me të njëjtën logjikë, çdo vendimmarrje është e dokumentuar dhe e gjurmueshme, dhe çdo qytetar apo biznes trajtohet me të njëjtin standard. Një sistem ku kontrolli shtetëror nuk perceptohet si pengesë, por si garanci për siguri, drejtësi dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Ky është një vizion që i shërben të gjithëve: shtetit, për të ushtruar funksionet e tij me integritet; biznesit, për të operuar në një mjedis të drejtë dhe të parashikueshëm; dhe qytetarëve, për të pasur besim se ligji zbatohet njësoj për të gjithë.

Në këtë rrugëtim, mbështetja dhe bashkëpunimi i të gjitha niveleve – nga drejtuesit më të lartë të qeverisjes deri te çdo qytetar – është thelbësor. Reforma e inspektimeve nuk është një proces i izoluar institucional; ajo është një përpjekje e përbashkët për të ndërtuar një shtet më të drejtë, më transparent dhe më funksional.

Në përfundim, viti 2025 mund të konsiderohet si një vit tranzicioni dhe themelimi. Themelet janë vendosur. Sfida tani është konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm. Me përkushtim, profesionalizëm dhe bashkëpunim, jam i bindur se do të arrijmë të ndërtojmë një sistem inspektimi që i përgjigjet standardeve më të larta dhe pritshmërive të shoqërisë sonë.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe besimin tuaj.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Dashnor SULA

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

Mesazhi i Inspektorit të Përgjithshëm....1
Tabela e Përmbajtjes....3
Legjenda e Institucioneve....4
I. Përmbledhje....5
II. Qëllimi....13
III. Metodologjia....13
IV. Veprimtaria Inspektoratit Qendror për Vitin 2025....14
V. Raportimi i veprimtarisë së trupave inspektuese sipas ministrive të linjës....15
1. Kryeministria....15
1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave....15
2. Ministria e Punëve të Brendshme....17
2.1.Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit....17
3. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit....20
3.1.Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore....20
3.2.Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut....23
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë....27
4.1.Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial....27
4.2.Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera....33
5. Ministria e Arsimit....37
5.1.Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar....37
6. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural....38
6.1.Autoriteti Kombëtar i Ushqimit....38
6.2.Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës....41
6.3.Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura....43
7. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale....46
7.1.Inspektorati Shtetëror Shëndetësor....46
7.2.Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore....51
7.3.Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet....54
8. Ministria e Mjedisit....57
8.1.Agjencia Kombëtare e Mjedisit....57
9. Ministria E Turizmit, Kulturës dhe Sportit....59
9.1. Agjencia Kombëtare e Bregdetit....59
VI. Raportimi i Veprimtarisë për Inspektoratet Vendore....61
VII. Raport Monitorimi i Buxhetit për Vitin 2025, Inspektorati Përgjithshëm....62
VIII. Konkluzione....67
IX. Rekomandime....68
X. Objektivat për Vitin 2026....70

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Legjenda e Institucioneve

AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AKBPM	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKSEM	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
AKZM	Agjencia Kombëtare E Zonave të Mbrojtura
DINGN	Drejtoria e Inspektimi të Naftës e Gazit dhe Nënprodukteve
DIPIE	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike
DIPNP	Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion
DSGIK	Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit e Impianteve Kombëtare
DTAM	Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
DPI	Drejtoria e Pronësisë Intelektuale
DSHPA	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IQ	Inspektorati Qendror
ISHMT	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
OMP	Organizata e Menaxhimit të Peshkut
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZMR	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

I. PËRMBLEDHJE

Reforma në sistemin e inspektimeve, e mbështetur në ligjin nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ka krijuar bazat për ndërtimin e një sistemi të unifikuar kombëtar, të orientuar nga analiza e riskut, standardizimi i procedurave dhe rritja e transparencës në marrëdhëniet ndërmjet administratës, biznesit dhe qytetarëve. Kuadri i ri ligjor ka vendosur parime të qarta për organizimin, funksionimin dhe profesionalizimin e veprimtarisë inspektuese, duke sjellë një qasje moderne të bazuar në parandalim, ndërgjegjësim dhe vetëpërmirësim të subjekteve të inspektuara, ku paralajmërimi vendoset si masë administrative kryesore në inspektimin e parë.

Gjatë vitit 2025, Inspektorati i Përgjithshëm ka luajtur një rol kyç në zbatimin e reformës, përmes hartimit të akteve nënligjore, standardizimit të dokumentacionit, përmirësimit të sistemit elektronik "e-Inspektimi", si dhe forcimit të kapaciteteve të trupave inspektuese. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të trajnimit dhe certifikimit të inspektorëve, trajtimit të ankesave dhe ngritjes së mekanizmave të rinj institucionalë, si Komisionet e Shqyrtimit të Ankimit, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së sistemit.

Megjithatë, zbatimi i reformës ka evidentuar një sërë sfidash që kërkojnë adresim të mëtejshëm. Ndër to përfshihen nevoja për harmonizimin e plotë të legjislacionit sektorial me kuadrin e ri ligjor, përshtatja e strukturave organizative sipas modelit të sistemit të unifikuar, si dhe forcimi i kapaciteteve profesionale dhe teknike të trupave inspektuese, veçanërisht në sektorë me kompleksitet të lartë. Po ashtu, mbetet thelbësore lidhja më e fortë ndërmjet analizës së riskut dhe planifikimit të burimeve, si dhe ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm trajnimi dhe certifikimi profesional.

Një sfidë e rëndësishme gjatë vitit 2025 ka qenë funksionimi i kufizuar i sistemit "e-Inspektimi", për shkak të ndërprerjes së shërbimit të mirëmbajtjes, duke ndikuar në realizimin e inspektimeve online dhe në efikasitetin e procesit. Kjo situatë ka detyruar përdorimin e përkohshëm të procedurave shkresore dhe ka rritur ngarkesën e punës për inspektorët, duke theksuar nevojën për garantimin e qëndrueshmërisë teknologjike të sistemit.

Gjithashtu, janë evidentuar problematika të përsëritura, si mungesa e përdorimit të plotë të sistemit elektronik nga disa inspektorate, mosmiratimi në kohë i planeve vjetore, mungesa dhe përditësimi i listë-verifikimeve, si dhe kufizime në infrastrukturën teknologjike. Këto çështje ndikojnë drejtpërdrejt në zbatimin efektiv të metodologjisë së inspektimeve me bazë risku dhe në arritjen e objektivave të reformës.

Në tërësi, megjithë progresin e arritur, konsolidimi i mëtejshëm i reformës kërkon angazhim të shtuar institucional, investime në kapacitete njerëzore dhe teknologjike, si dhe përmirësim të koordinimit ndërinstitucional. Zbatimi i plotë i këtyre masave do të mundësojë funksionimin e një

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

sistemi inspektimi modern, efikas dhe të besueshëm, në shërbim të interesit publik, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Përshkrimi i situatës së sistemit të inspektimeve dhe arritjet kryesore në kuadër të reformës së inspektimit gjatë vitit 2025 dhe arritjet nga zbatimi i deritanishëm i ligjit nr. 99/2024 për inspektimin.

1. Konsolidimi i modelit të unifikuar të inspektimit

Reforma ka vendosur themelet për:

- ✓ riorganizimin e inspektorateve;
- ✓ unifikimin e procedurave inspektuese në nivel kombëtar;
- ✓ rritjen e koordinimit institucional ndërmjet inspektorateve;
- ✓ forcimin e rolit metodologjik të Inspektoratit të Përgjithshëm.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 janë miratuar 8 akte nënligjore, të cilat përbëjnë bazën rregullatore për funksionimin e sistemit të ri të inspektimeve.

2. Orientimi drejt inspektimit me bazë risku

Një nga risitë kryesore të ligjit është planifikimi i inspektimeve bazuar në analizën e riskut. Gjatë vitit 2025 është avancuar në rishikimin e metodologjisë së riskut, janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e dokumenteve standarde të inspektimit dhe listë-verifikimet, është nisur procesi i konfigurimit të objekteve të inspektimit në sistemin "e-Inspektimi".

Megjithëse ky proces mbetet në zhvillim, ai përfaqëson një ndryshim thelbësor në filozofinë e inspektimit, nga një qasje reaktive në një qasje parandaluese dhe të targetuar.

3. Dixhitalizimi dhe modernizimi i procesit inspektues

- ✓ Është vijuar përdorimi i sistemit unik elektronik "e-Inspektimi", si platformë qendrore e administrimit të inspektimeve.
- ✓ Është implementuar nënshkrimi elektronik i akteve inspektuese dhe vulosja elektronike e dokumenteve.
- ✓ Janë trajnuar 515 inspektorë për përdorimin e aplikacionit dhe procedurave elektronike në sistemin e inspektimeve.
- ✓ Janë shpërndarë pajisje teknologjike (16-tableta) për mbështetjen e inspektimeve në terren.

Këto zhvillime kanë kontribuar në rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe standardizimit të veprimeve inspektuese.

4. Vendosja e qasjes parandaluese në inspektim, si risi e Ligjit nr. 99/2024 ka sjellë një ndryshim thelbësor përmes:

- ✓ vendosjes së paralajmërimit si masë kryesore në inspektimin e parë,
- ✓ promovimit të një qasjeje të bazuar në informim, ndërgjegjësim dhe vetëpërmirësim të subjekteve.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Kjo ka ndikuar në uljen e barrës administrative për biznesin, rritjen e bashkëpunimit me subjektet e inspektuara, orientimin e sistemit drejt parandalimit dhe jo vetëm ndëshkimit.

5. Forcimi i kapaciteteve profesionale të trupës inspektuese

- ✓ Është realizuar vlerësimi dhe testimi i inspektorëve të rinj (15 inspektorë).
- ✓ Janë pajisur me kartë inspektori 95 inspektorë, duke rritur formalizimin dhe përgjegjshmërinë në ushtrimin e detyrës.
- ✓ Është përditësuar Regjistri Unik i Inspektorëve, si një instrument kyç për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Këto masa kontribuojnë në profesionalizimin dhe standardizimin e trupës inspektuese.

6. Ngritja e mekanizmit të ankimit administrative, si një risi e rëndësishme në funksionimin e sistemit dhe rolit të Inspektoratit të përgjithshëm:

- ✓ Trajtimi i ankesave dhe konstituimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit ishte një risi për vitin 2025, ku u ndërmorën hapa të rëndësishëm për ngritjen dhe funksionalizimin e sistemit të shqyrtimit të ankimeve, në përputhje me ligjin nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 407, datë 16.07.2025, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit". Në këtë kuadër, u krijua sekretariati teknik pranë Inspektoratit të Përgjithshëm dhe u ngritën Komisionet e Shqyrtimit të Ankimit sipas fushave të inspektimit, me qëllim trajtimin e ankimeve administrative ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit dhe veprimtaria e KSHA, filloi në vitin 2026.
- ✓ Gjatë periudhës 13 maj – 31 dhjetor 2025 u administruan gjithsej 173 ankime. Pjesa më e madhe e tyre lidhej me vendimet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH).

7. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së veprimtarisë inspektuese

- ✓ Janë trajtuar 50 ankesa/kërkesa nga qytetarë dhe subjekte,
- ✓ është përditësuar Programi i Transparencës,
- ✓ janë dhënë mendime për nisma ligjore dhe nënligjore, duke garantuar harmonizim me kuadrin e ri ligjor.

8. Sigurimi i vijueshmërisë së procesit në kushte sfiduese, ku pavarësisht problemeve me mirëmbajtjen e sistemit "e-Inspektimi":

- ✓ funksionimi i kufizuar i sistemit "e-Inspektimi", për shkak të ndërprerjes së shërbimit të mirëmbajtjes, duke ndikuar në mosrealizimin e inspektimeve online dhe në efikasitetin e procesit. Kjo situatë ka detyruar përdorimin e përkohshëm të procedurave shkresore dhe ka rritur ngarkesën e punës për inspektorët, duke theksuar nevojën për garantimin e qëndrueshmërisë teknologjike të sistemit.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

- ✓ kryen inspektime 16 inspektorate.
- ✓ është ofruar mbështetje metodologjike e vazhdueshme nga Inspektorati i Përgjithshëm.

Problematikat e hasura gjatë vitit 2025

1. *Mospërputhje dhe mungesë harmonizimi ligjor dhe institucional*
   - Mungesa e harmonizimit të plotë të legjislacionit sektorial dhe akteve nënligjore me ligjin nr. 99/2024; Legjislacioni sektorial dhe aktet nënligjore nuk janë plotësisht të përafruara me ligjin nr. 99/2024, duke krijuar mbivendosje kompetencash dhe mungesë unifikimi procedural.
   - Përshtatje e pamjaftueshme e strukturave organizative me modelin e sistemit të unifikuar; Inspektoratet nuk janë ende tërësisht të organizuara sipas modelit të sistemit të unifikuar dhe rolit metodologjik të Inspektoratit të Përgjithshëm.
   - Bashkëpunim i pamjaftueshëm ndërinstitucional.

2. *Kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe profesionale*
   - Mungesë e kapaciteteve analitike dhe teknike për zbatimin e metodologjisë së riskut; Nevojë për rritjen e aftësive analitike, njohurive mbi metodologjinë e riskut dhe ekspertizës sektoriale të trupave inspektuese.
   - Mungesa e një sistemi të konsoliduar trajnimi dhe certifikimi; Ende nuk është ndërtuar plotësisht një sistem i qëndrueshëm dhe i unifikuar për formimin profesional të inspektorëve.
   - Kapacitete të kufizuara në trajtimin e ankimeve si në staf, ashtu dhe në eksperiencë. Mungesë stafi, eksperiencë e kufizuar, vonesa procedurale dhe probleme infrastrukturore.

3. *Dobësi në planifikim dhe në zbatimin e metodologjisë së riskut*
   - Lidhje e pamjaftueshme ndërmjet analizës së riskut dhe planifikimit të burimeve; Alokimi i burimeve njerëzore dhe financiare nuk reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë prioritetet e riskut.
   - Konfigurim i paplotë i objekteve të inspektimit dhe listë-verifikimeve për vlerësimin e riskut; Disa procedura të rëndësishme nuk kanë listë-verifikime të hartuara ose të përditësuara.
   - Mospërputhje ndërmjet programeve të miratuara dhe atyre të gjeneruara në sistem; Diferenca ndërmjet planeve të miratuara dhe të dhënave në sistem sjell mosrealizim të objektivave të inspektimit.
   - Mosmiratim në kohë i planeve vjetore të inspektimit, ndikon negativisht në planifikimin dhe realizimin e inspektimeve.
   - Mungesë ose përditësim i pamjaftueshëm i listë-verifikimeve.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

4. *Problematika në përdorimin dhe funksionimin e sistemit "e-Inspektimi"*
   - Ndërprerja e mirëmbajtjes së sistemit dhe funksionalitet i kufizuar e cila ka sjellë vështirësi në kryerjen e inspektimeve online dhe në përditësimin e dokumentacionit standard. Me kthimin e përkohshëm në procedura shkresore, si pasojë e problemeve teknike, është rritur ngarkesa e punës dhe është ulur efikasiteti i procesit inspektues.
   - Kapacitete të pamjaftueshme teknike të sistemit (hapësirë, performancë, bllokime); Ezaurimi i hapësirës dhe probleme teknike që shkaktojnë bllokime dhe ulje performance.
   - Konfigurim i paplotë i moduleve të riskut; Vështirësi në përcaktimin e peshave dhe strukturimin e listë-verifikimeve, duke kufizuar zbatimin e plotë të metodologjisë së riskut.
   - Vështirësi në përdorimin e nënshkrimit dhe vulosjes elektronike (mungesë NIPT për disa struktura), sidomos për strukturat që nuk janë të pajisura me NIPT.
   - Mungesë e përdorimit të plotë të sistemit nga inspektoratet (mungesë vullneti institucional); Në disa inspektorate vijon të mos përdoret plotësisht sistemi "e-Inspektimi", veçanërisht në sektorë specifikë.
   - Mosrealizim i plotë i inspektimeve nëpërmjet pajisjeve teknologjike (tabletë).

5. Mungesë infrastrukture dhe mbështetjeje teknologjike
   - Pajisje të pamjaftueshme teknologjike për inspektimet online (p.sh. tabletë) dhe kufizime teknike për realizimin e inspektimeve online.
   - Kufizime infrastrukturore që ndikojnë në funksionimin e sistemit;
   - Varësi nga zgjidhje tranzitore (procedura shkresore), duke ulur efikasitetin e veprimtarisë inspektuese.

6. Problematika në menaxhimin dhe standardizimin e procedurës inspektuese
   - Kthim i përkohshëm në procedura tradicionale për shkak të problemeve teknike;
   - Mungesë unifikimi të plotë të metodave të programimit, monitorimit dhe raportimit të performancës;
   - Vijimësi e problematikave të evidentuara në vitet e mëparshme, pavarësisht rekomandimeve. Tregon mungesë të adresimit efektiv të rekomandimeve të dhëna më parë.

Këto problematika tregojnë nevojën për masa të menjëhershme dhe të koordinuara për të garantuar funksionimin e plotë dhe efektiv të sistemit të unifikuar të inspektimeve.


Qëllimi nuk qëndron thjesht të përmirësimi i një procedure. Qëllimi është vendosja e një standardi të njëjtë inspektimi në të gjithë territorin, me të njëjtën logjikë planifikimi, me të njëjtën gjurmueshmëri dhe me të njëjtën përgjegjësi institucionale. Mbi këtë bazë, kontrolli zyrtar forcohet, qytetari fiton besim dhe ligji merr të njëjtën vlerë për të gjithë.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Në përfundim, në frymën e reformës, viti 2025 përfaqësoi një fazë tranzicioni dhe konsolidimi drejt një sistemi inspektimi të unifikuar, të dixhitalizuar, të orientuar nga analiza e riskut, dhe të bazuar në parandalim dhe transparencë.
Megjithëse reforma kërkon ende konsolidim në disa drejtime (harmonizimi ligjor, kapacitetet teknike dhe funksionaliteti i plotë i sistemit), arritjet e vitit 2025 dëshmojnë për vendosjen e themeleve të një sistemi modern dhe të besueshëm të inspektimeve në Shqipëri.



Inspektoratet shtetërore përgjatë vitit 2025, kanë kryer gjithsej 69523 inspektime, nga të cilat të programuara 52130 dhe jashtë programit 17393, kjo krahasuar me 2024 që janë 84160 inspektime nga të cilat 66581 janë të programuara dhe 17579 janë jashtë programit.




	ISHPSHSH	AKU	AKM	AKAP	ISHTI	ISHSH	ZMR	AKSEM	ISHMT	IKMT	AKBPM	DSHPA	DPA	AKB	AKZM
Programuar 2024	7927	23884	1438	271	5752	21250	141	622	2796	0	446	1324	338	347	24
Jashtë programi 2024	2756	8619	472	52	998	3142	4	20	187	936	24	19	28	205	100
Programuar 2025	6.434	15.021	719	486	5723	19488	49	429	2333	56	279	720	225	144	24
Jashtë programi 2025	3098	7.755	1.045	13	683	4208	33	10	112	232	7	15	6	110	66

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Në grafikun më poshtë paraqiten inspektimet e realizuara në vitin 2025, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2024, ku vihet re një rënie e inspektimeve gjithsej prej 17 %, ku evidentohet një rënie e inspektimeve të programuara me rreth 22 %, ndërsa inspektimet jashtë programi kanë një rënie të lehtë me 1 % , për të gjitha inspektoratet shtetërore.

Aktiviteti inspektues i programuar dhe ai jashtë programit për vitin 2025, krahasuar me inspektimet e kryera në vitin 2024, paraqitet sipas grafikut më poshtë.




Masa Administrative Gjobë 2024


Për shkeljet e konstatuara, për vitin 2025 inspektoratet shtetërore kanë marrë gjithsej 631 masa administrative "gjobë, ndërsa për vitin 2024 inspektoratet shtetërore kanë marrë gjithsej 1323 masa administrative "gjobë", ndërsa për vitin 2023 janë marrë 1362 masa administrative gjobë. Vihet re një zbritje prej 52 % masa administrative "gjobë" më pak, në vitin 2025 krahasuar me 2024.

Shpërndarja e masave administrative sipas ISH-ve, grafike në vijim:

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al



Në mënyrë grafike, pasqyrohen të dhënat mbi Vendimet Përfundimtare të Inspektimit, të marra me masë administrative gjobë për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 dhe 2023.



Evidentohet një rënie e masave administrative gjobë me 52 % krahasuar me vitin 2024 dhe me 47 % krahasuar me vitin 2023, ndikuar kjo edhe nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 99/2024.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

II. QËLLIMI

Ky raport pasqyron në mënyrë të përmbledhur funksionimin e sistemit të inspektimit në tërësinë e komponentëve të tij, përmes aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2025 nga Inspektorati i Përgjithshëm dhe inspektoratet shtetërore dhe synonon të paraqesë progresin e arritur në zbatimin e reformës në sistemin e inspektimeve; të identifikojë problematikat kryesore gjatë vitit 2025; të evidentojë nevojat për konsolidimin e mëtejshëm të sistemit; të japë rekomandime për përmirësimin e funksionimit të tij.

III. METODOLOGJIA

Inspektorati i Përgjithshëm, në zbatim të germës d, të nenit 18, të ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të germës d, pika 5, kreu III, të vkm nr. 330/2025[1], përgatit Raportin e Përgjithshëm Vjetor të Inspektimeve. Ky raport hartohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit për inspektimin dhe ligjeve sektoriale përkatëse, duke siguruar mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave të gjeneruara nga sistemi elektronik "e-Inspektimi", raportimet vjetore të vëna në dispozicion nga inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe aktet e tjera administrative që rregullojnë procesin inspektues.

Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese, nëpërmjet sistemit "e-Inspektimi", realizohet përmes nxjerrjes dhe analizës së të dhënave nga modulet përkatëse, përfshirë modulin e programimit, çështjet e inspektimit, raportet dhe statistikat e veprimtarisë inspektuese, regjistrin e gjobave, si dhe dokumentacionin tjetër justifikues të përdorur gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.

Të dhënat e analizuara për hartimin e këtij raporti janë marrë nga moduli "Raporte" dhe "Moduli i çështjeve të inspektimit", nëpërmjet përdorimit të filtrave "hapur nga" dhe "mbyllur deri". Për zbatimin e ligjit nr. 10433/2011, analiza përfshin periudhën kohore nga 01.01- 13.05.2025, ndërsa për zbatimin e ligjit nr. 99/2024, të dhënat janë marrë nga moduli i programimit dhe çështjet shkresore për periudhën nga 13.05-31.12.2025.

Në hartimin e këtij raporti, një rëndësi të veçantë i është kushtuar edhe informacionit të siguruar nëpërmjet raportimeve të veprimtarisë së inspektorateve shtetërore dhe vendore për vitin 2025, të depozituara pranë Inspektoratit të Përgjithshëm. Ky informacion është trajtuar dhe analizuar sipas problematikave të evidentuara, masave dhe zgjidhjeve të ndërmarra, rezultateve të arritura, si dhe objektivave të përcaktuara për periudhat në vijim.

Në vijim të këtij raporti paraqiten, në mënyrë të përmbledhur, arritjet kryesore, problematikat e hasura dhe objektivat për Inspektoratin e Përgjithshëm, inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera

[1] "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm"

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

inspektuese, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë inspektuese.

IV. VEPRIMTARIA E INSPEKTORATIT QENDROR PËR VITIN 2025

Inspektorati i Përgjithshëm, në cilësinë e institucionit përgjegjës kryesor në fushën e inspektimit, gjatë vitit 2025 ka ushtruar veprimtarinë e tij me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë inspektuese, përmes zhvillimit të aktiviteteve të orientuara drejt rritjes së performancës, eficiencës dhe transparencës së procesit inspektues, ku realizoi objektivat e mëposhtme:

- ✓ Hartimin dhe miratimin e 8 akteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
- ✓ Hartimin e materialit analitik që analizon të gjitha kërkesat ligjore dhe teknike për zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit "e-Inspektimi", në funksion të zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 99/2024, si dhe paraqitjen e tij pranë AKSHI-t;
- ✓ Hartimin e projektaktit nënligjore për përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit elektronik *"e-Inspektimi"*, si dhe 5 projekt akte që janë në proces;
- ✓ Informimin dhe orientimin e trupa inspektuese drejt këshillimit dhe paralajmërimit të subjekteve të inspektimit sipas parimeve të ligjit të ri të inspektimit nëpërmjet shkresave zyrtare;
- ✓ Kryerja e inspektimeve *online* dhe shkresore nga 16 inspektorate shtetërorë në sistemin elektronik *"e-Inspektimi"*, me program vjetor dhe mujor sipas zbatimit të legjislacionit në fuqi për inspektimin;
- ✓ Në kuadër të përmirësimeve të vazhdueshme të aplikacionit mobile të sistemit unik elektronik "e-Inspektimi", janë zhvilluar trajnime me qëllim rritjen e eficiencës dhe lehtësimin e realizimit të procedurave të inspektimit. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2025 janë trajnuar gjithsej 515 inspektorë të inspektorateve shtetërore, përfshirë 215 inspektorë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), 53 inspektorë të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), 130 inspektorë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, 117 inspektorë të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- ✓ Vlerësimi dhe testimi i aftësive profesionale për 15 inspektorë në kohë prove, ku marrëdhënia e punës rregullohet sipas Kodit të Punës (AKU-7; ISHSH-8; ISHTI-9);
- ✓ Mbështetja metodologjike për të gjitha inspektoratet shtetërore për përditësimin e listë-verifikimeve dhe dokumenteve standarde, në varësi të ndryshimeve ligjore;
- ✓ Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese *online* për të gjitha inspektoratet shtetërore, që kryejnë veprimtarinë inspektuese nëpërmjet sistemit *"e-Inspektimi"*, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, ku u identifikuan problematikat, si dhe u dhanë rekomandime për përmirësimin e procesit inspektues;

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

- ✓ Dhënia e mendimeve dhe komenteve për nismat ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit, me qëllim harmonizimin e kuadrit ligjor për inspektimet;
- ✓ Trajtimi në kohë dhe me cilësi i 50 ankesave/kërkesave të individëve/subjekteve për shqyrtimin e procedurave inspektuese apo denoncimeve të ndryshme;
- ✓ Përditësimi i Regjistrit Kombëtar të inspektorëve në detyrë për inspektoratet shtetërore, bazuar kjo në lëvizjet e burimeve njerëzore inspektuese;
- ✓ Pajisja e 95-inspektorëve me kartë inspektori (AKU-22, ISHSH-11, ISHPSHP-15, ISHMT-2, IKMT-11, ISHTI-6, AKAP-12, AKM-2, AKB-2, AKZM-11 dhe AKMC-1), ku para fillimit të procedurës së inspektimit, inspektori ka detyrimin ligjor të identifikohet me kartën e inspektorit, si dhe sigurimi i 16 pajisjeve tabletë për AKBPM-5, AKAP-2, AKM-4 dhe APR-4.

V. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS KRYEMINISTRISË DHE MINISTRIVE TË LINJËS.

1. KRYEMINISTRIA


1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA)

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është struktura përgjegjëse për sigurimin dhe zbatimin e legjislacionit arkivor në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat" i ndryshuar, dhe të norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë".

DPA, nëpërmjet trupës inspektuese vazhdon të mbledhë të dhëna arkivore për të gjitha subjektet shtetërore që përbëjnë rrjetin arkivor kombëtar duke krijuar "databazën me institucione fondkrijuese, si një sistem mirëmenaxhimi, monitorimi dhe mbikëqyrësi veprimtarisë së tyre.

Gjatë vitit 2025, DPA ka kryer 231 inspektime në të gjithë territorin, nga të cilat 225 inspektime të programuara dhe 6 jashtë programi, të kryera nëpërmjet sistemin "e-Inspektimi" dhe në formë shkresore.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al



DPA është përgjegjëse për 3 fusha inspektimi për të cilat realizon veprimtarinë inspektuese. Gjatë vitit 2025, janë realizuar inspektime vetëm në 1 fushe: Inspektimi për zbatimin e detyrave në sekretari -arkiv.

Gjatë vitit 2025, janë marrë 126 Vendime Përfundimtare Inspektimi me masë administrative "Paralajmërim", dhe nuk është marre asnjë :"Gjobe".

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": DPA e realizon veprimtarinë inspektuese online, 100 % nëpërmjet pajisjeve tabletë. Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të Inspektimit për vitin 2025 dhe në programe mujore të hartuara me listë subjektesh inspektimi me bazë risku, por këto programe nuk dërgohen gjithmonë, pranë Inspektoratit Qendror brenda afateve ligjore, të parashikuara në vkm nr. 696/2013.

Problematika: Nga mbikëqyrja online e veprimtarisë inspektuese në tërësi, gjetjet e evidentuara lidhen kryesisht me aspekte të dokumentimit, standardizimit dhe administrimit të procedurave inspektuese në sistemin "e-Inspektimi", të cilat kërkojnë përmirësim me qëllim rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe qëndrueshmërisë juridike të veprimtarisë inspektuese.

Objektivat: Për vitin 2026, në bazë të programit vjetor të inspektimit është planifikuar kryerja e 353 inspektimeve në institucione (subjekte), nga të cilat 350 të programuara dhe 3 të paprogramuara, nga ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të kryhen online, me tableta, konform rregullave të miratuara në ligjin për inspektimin dhe ligjin sektorial.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

2. *MINISTRIA E PUNËVË TË BRENDSHME*

2.1 Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)

IKMT është institucion qendror buxhetor publik, me statusin e personit juridik, në varësi të Ministrisë së Brendshme. Ai ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet strukturës qendrore dhe 12 drejtorive rajonale.

Misioni i IKMT-së është garantimi i ligjshmërisë në zbatimin e legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe mbrojtja e mjedisit, ujërave dhe pyjeve nga ndërhyrjet e kundërligjshme.

Inspektorati i Përgjithshëm, në ushtrim të përgjegjësisë së tij për mbikëqyrjen e ligjshmërisë, standardizimit dhe efektivitetit të veprimtarisë inspektuese, ka analizuar rezultatet e veprimtarisë së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit gjatë vitit 2025.

Viti 2025 përbën një periudhë prove për veprimtarinë inspektuese të IKMT-së. Ky vit përkoi me kalimin nga kuadri i mëparshëm ligjor në ligjin nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", duke e vendosur kontrollin shtetëror përballë një kërkese më të lartë: jo vetëm të jetë i pranishëm në territor, por edhe të jetë i unifikuar në standarde, i dokumentuar dhe i gjurmueshëm.

IKMT ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes strukturës qendrore dhe 12 drejtorive rajonale. Fusha e përgjegjësisë së tij përfshin kontrollin e zbatimit të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe kontrollin në fushat e mjedisit, ujërave dhe pyjeve. Në një institucion si IKMT, mënyra se si planifikohet, dokumentohet dhe gjurmohet kontrolli nuk është vetëm çështje administrative; ajo lidhet drejtpërdrejt me sigurinë juridike, transparencën dhe besimin publik në ushtrimin e kontrollit shtetëror.

Të dhënat e vitit 2025 tregojnë se në sistemin "e-Inspektimi" janë regjistruar 417 çështje, nga të cilat 288 me status të mbyllur, 24 të anuluara, 97 në progres, 5 të hapura dhe 3 në pritje. Po ashtu, janë regjistruar 67 çështje me masë administrative gjobë.


Për vitin 2025 janë miratuar 56 inspektime të programuara, nga të cilat 30 janë realizuar brenda programit, ndërsa 26 janë kryer jashtë programit, duke përbërë 46% të totalit të inspektimeve të realizuara.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Tabela 1. Treguesit kryesore të veprimtarisë inspektuese te IKMT-se gjate vitit 2025

Treguesi	Vlera	Lexim i shkurtër
Çështje të regjistruara gjithsej në sistem	417	Baza e çështjeve te administruara ne "e-Inspektimi".
Çështje të mbyllura	288	Pesha kryesore e çështjeve te përfunduara ne sistem.
Çështje në progres	97	Tregon nevojën për ndjekje me te forte të ecurisë se procedurave.
Çështje me mase administrative gjobe	67	Tregues i masave administrative te regjistruara ne sistem.
Inspektime te realizuara brenda programit	30	Realizim i pjesshëm i programimit te miratuar.
Inspektime te realizuara jashtë programit	26	Peshe e larte e veprimtarisë jashtë programimit.
Pesha e inspektimeve jashtë programit	46%	Tregon nevojën për konsolidim te planifikimit.

Grafiku 1. Inspektimet e realizuara brenda dhe jashtë programit - IKMT, 2025



Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Nga 56 inspektime të realizuara në total gjatë vitit 2025, 30 janë kryer brenda programit dhe 26 jashtë tij. Inspektimet jashtë programit përbëjnë rreth 46% të totalit të inspektimeve të realizuara.

Ky bilanc tregon se IKMT ka ruajtur praninë e kontrollit në një fushë me ndjeshmëri të lartë për interesin publik. Në të njëjtën kohë, viti 2025 evidentoi nevojën për një fazë të re konsolidimi: më shumë planifikim, më shumë njëtrajtshmëri në dokumentim dhe përdorim më efektiv të sistemit unik elektronik.

Në drejtim të planifikimit, viti 2025 tregoi se programimi i veprimtarisë inspektuese mbetet i pjesshëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se programi vjetor i paraqitur për vitin 2025 është kufizuar në fushën e inspektimit në ujëra, ndërsa për fushat e tjera në kompetencë të IKMT-së nuk rezulton një program i plotë, i strukturuar dhe i dokumentuar. Në të njëjtën linjë, programet mujore nuk janë dorëzuar në mënyrë të plotë dhe të rregullt. Kjo ka kufizuar mundësinë e koordinimit dhe të mbikëqyrjes efektive nga Inspektorati i Përgjithshëm, si dhe ka sjellë një peshë të lartë të veprimtarisë jashtë programit.

Në përdorimin e sistemit unik elektronik "e-Inspektimi" mbetet një dallim i qartë ndërmjet fushave të inspektimit. Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit nuk i ka realizuar inspektimet në sistem, duke e administruar procesin përmes dokumenteve të parashtypura me numër serial. Në tërësi, veprimtaria inspektuese ende nuk mbështetet në mënyrë të plotë dhe të njëtrajtshme në sistemin unik elektronik. Kjo kufizon gjurmueshmërinë e plotë të procesit, ul transparencën dhe e bën më të vështirë monitorimin në kohë reale.

Po aq e rëndësishme mbetet edhe njëtrajtshmëria e dokumentimit. Gjatë vitit 2025, kufizimet në funksionimin e sistemit "e-Inspektimi" ndikuan në dokumentimin dhe ndjekjen e procedurës së inspektimit. Dokumentacioni shkresor mundësoi vijimësinë e veprimtarisë gjatë periudhës së tranzicionit. Megjithatë, standardi i reformës nuk mund të mbështetet mbi zgjidhje të përkohshme; ai kërkon administrim të plotë dhe të gjurmueshëm të procedurave në sistemin unik elektronik.

Në të njëjtën kohë, mbivendosja e kompetencave në disa fusha ndërmjet IKMT-së dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbetet një çështje që kërkon vëmendje të veçantë. Kjo situatë mban të hapur rrezikun për dublikim kontrollesh, rritje të barrës administrative dhe fragmentim të përgjegjësisë institucionale. Konsolidimi i reformës dhe forcimi i mekanizmave të bashkërendimit ndërinstitucional mbeten thelbësore për adresimin e qëndrueshëm të kësaj problematike.

Nga mbikëqyrja e ushtruar janë evidentuar gjithashtu nevoja për standardizim të mëtejshëm të dokumenteve dhe të procedurës administrative të inspektimit. Janë konstatuar raste të autorizimeve të hartuar nga inspektori dhe jo nga Kryeinspektori; mungesë e referimit të plotë të bazës ligjore; mangësi në përcaktimin e objektit të inspektimit; përdorim jo i njëtrajtshëm i listave të verifikimit; mungesë nënshkrimesh në aktet e inspektimit; si dhe raste kur vendimi përfundimtar nuk është marrë në përputhje të plotë me afatet dhe kërkesat procedurale të legjislacionit në fuqi. Këto nuk

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

janë vetëm çështje formale, por prekin drejtpërdrejt standardin e ligjshmërisë dhe besueshmërinë e procesit inspektues.

Në vlerësimin e përgjithshëm, viti 2025 tregon se IKMT ka ruajtur kapacitetin operacional në ushtrimin e funksioneve të kontrollit. Njëkohësisht, ai dëshmon se faza e re kërkon më shumë sesa prani në terren: kërkon planifikim më të plotë, dokumentim më të njëtrajtshëm, përdorim më të gjerë të sistemit elektronik dhe forcim të standardeve procedurale të inspektimit. Këtu qëndron edhe rezultati kryesor i vitit 2025: qartësimi i hapave të nevojshëm për kalimin nga një model me dokumentim të pjesshëm drejt një modeli të bazuar në gjurmueshmëri, standardizim dhe koordinim më të fortë institucional.

3. *MINISTRIA E* EKONOMISË DHE INOVACIONIT

3.1 *Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)*


Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kryen veprimtarinë e tij përmes procesit të inspektimit, me qëllim verifikimin e zbatimit të legjislacionit të punës dhe shërbimeve shoqërore nga subjektet, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, përfshirë ligjin nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". ISHPSHSH ushtron funksione kontrolluese, këshilluese, parandaluese dhe ndëshkuese në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shërbimeve shoqërore.

ISHPSHSH është struktura përgjegjëse për garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në këto fusha dhe operon në nivel qendror dhe rajonal, nëpërmjet gjashtë drejtorive rajonale dhe strukturave përkatëse inspektuese.

Procesi i inspektimit është zhvilluar kryesisht përmes sistemit elektronik "e-Inspektimi", si dhe nëpërmjet dokumentacionit shkresor, për shkak të ndërprerjeve në funksionimin e sistemit gjatë vitit. ISHPSHSH ka inspektuar 205,196 vende pune në 9,532 subjekte, me rritje prej 8% të vendeve të punës të verifikuara krahasuar me vitin e kaluar, nga të cilat **27.7%** janë subjekte të inspektuara për herë të parë.

Gjatë vitit 2025 ISHPSHSH ka kryer gjithsej 9,532 inspektime, nga të cilat, 6,434 inspektime të programuara; 3,098 inspektime jashtë programit, të realizuara mbi bazë ankesash, monitorimi apo konstatimesh në terren (raste flagrante).

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al




Gjatë vitit 2025 janë inspektuar 205,196 vende pune, në 9,532 subjekte, nga të cilat 27.7% të inspektimeve në subjekte të reja (të painspektuara më parë). Nga këto inspektime janë vendosur 268 masa administrative "gjobë" për shkelje të konstatuara të legjislacionit në fuqi.

Në kuadër të luftës kundër informalitetit, gjatë vitit 2025, janë identifikuar 2,591 punëmarrës informalë, ku 98% e tyre janë formalizuar brenda procesit inspektues; konstatuar 2,999 punëmarrës pa kontrata pune, që përfaqëson një ulje prej 24% krahasuar me vitin 2024.
Formalizimi i marrëdhënieve të punës ka sjellë një kontribut shtesë prej 28,245,960 lekë në muaj në skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke reflektuar ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në qëndrueshmërinë e këtyre skemave.

Për vitin 2025 janë depozituar 1,179 ankesa gjithsej, për 963 raste është kryer procedurë inspektuese, nga të cilat 789 e tyre janë shoqëruar me masa administrative.

Aksidentet në punë. Nga 275 raste aksidentesh në punë, me 212 persona të aksidentuar, nga të cilët 48 me pasojë fatale, duke reflektuar një rritje krahasuar me vitin 2024. 100% të rasteve janë marrë masa administrative.



Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Në total janë vendosur masa administrative, si 4192 paralajmërime; 268 gjoba (me vlerë totale 64,584,000 lekë); 1269 masa urgjente (bllokim aktiviteti).

Karakteristikë e vitit 2025 ishte aplikimi i risisë së inspektimit sipas Ligjit nr. 99/2024, ku në shumicën e rasteve u aplikua masa e paralajmërimit si mekanizëm korrigjues dhe bashkëpunues, duke i dhënë subjektit mundësi për përmirësim përpara sanksionit.

Përgjatë vitit 2025, janë ankimuar gjithsej 28 masa administrative në Komisionin e Ankimit pranë ISHPSHSH-së, nga muaji janar 2025 deri në muajin qershor 2025, ku 19 masa administrative janë lënë në fuqi dhe 9 masë administrative janë dërguar për shqyrtim gjyqësor. Ndërsa pranë Inspektoratit të Përgjithshëm janë paraqitur 28 ankime.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": Programi vjetor dhe programet mujore janë hartuar sipas kërkesave ligjore; Megjithatë, ka devijime të konsiderueshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit të inspektimeve; Inspektimet jashtë programit kanë peshë të lartë, duke dobësuar orientimin me bazë risku. Gjithashtu, u evidentuan problematika në: zhvillimin e procedurës inspektuese në terren; dokumentimin dhe administrimin e provave; përdorimin e sistemit "e-Inspektimi"; vendimmarrjen përfundimtare dhe ndjekjen e masave.

Arritjet: Veprimtaria inspektuese e ISHPSHSH për vitin 2025 paraqet një nivel të mirë organizimi në aspektin formal të planifikimit. Ekziston një nivel i mirë organizimi në hartimin e programeve vjetore dhe mujore; Përdorimi i sistemit "e-Inspektimi" ka krijuar bazë për digjitalizimin e procesit; Janë ndërmarrë hapa drejt përdorimit të metodologjive të riskut (p.sh. platforma MIRA). Automatizimi i procesit programimit të inspektimit, me metodat e Inteligjencës Artificiale, mundëson një bazë të përmirësuar të dhënash të cilat shërbejnë në identifikim të problematikave të zbatimit të dispozitave ligjore, apo në përcaktim të sektorëve/ çështjeve që kanë nevojë për ndërhyrje; rritja e numrit të punonjësve të formalizuar në marrëdhëniet e punësimit, brenda procesit inspektues, për të zvogëluar inspformalitetin e të gjitha llojeve rritja e ndërgjegjësimit të punëdhënësve kundrejt detyrimeve ligjore, ku tashmë pjesë e njoftimeve bëhen jo vetëm aksidentet, por dhe incidentet në punë; informuar subjekte të reja të rregjistruara, mbi të drejtat dhe detyrimet e legjislacionit të punës në marrëveshje me QKB.

Problematika: Nga analiza e veprimtarisë inspektuese rezulton se problematikat janë me karakter sistemik, duke prekur të gjitha fazat e procesit inspektues: planifikimin, zhvillimin e procedurës, dokumentimin, vendimmarrjen, dhe ndjekjen e masave. Në tërësi evidentohet: mungesë standardizimi të plotë të procedurave; dobësi në dokumentimin dhe administrimin e provave; vendimmarrje jo e unifikuar dhe shpesh jo proporcionale; risk i lartë për përsëritje të shkeljeve dhe ulje të efektit parandalues. Zbatim jo i plotë i procedurave standarde të inspektimit; Mangësi në përdorimin e teknologjisë në terren; Dokumentim i pamjaftueshëm dhe jo i standardizuar;

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Mungesë konsistence në vendimmarrje dhe ndëshkueshmëri; Dobësi në monitorimin dhe mbylljen e ciklit të inspektimit.

Objektivat: Rritja e efektivitetit dhe profesionalizmit të veprimtarisë inspektuese përmes forcimit të kapaciteteve institucionale, burimeve njerëzore, infrastrukturës dixhitale dhe mbështetjes logjistike në të gjithë territorin e vendit; Përmbyllja dhe zbatimi i plotë i reformës përmes përshtatjes institucionale, rishikimit të strukturës organizative, standardizimit të procedurave operacionale dhe përditësimit të manualeve të punës, në përputhje me kuadrin e ri ligjor; Përmbushja e detyrimeve për raportim dhe monitorim në kuadër të *closing benchmarks*, si dhe zbatimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale në fushën e punësimit, sigurisë dhe shëndetit në punë; Zhvillimi dhe integrimi i mëtejshëm i sistemeve digjitale "MIRA" dhe "e-Inspektimi", me synim rritjen e eficiencës, transparencës, gjurmueshmërisë dhe cilësisë së proceseve inspektuese.

3.2 Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)

ISHMT, ka si mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale.

ISHMT, ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 36, datë 20.1.2016, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të mbikëqyrjes së tregut", i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore, duke inspektuar zbatimin e kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, mbrojtjes së pronësisë industriale, garantimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, të inspektimit metrologjik, të etiketimit për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, si dhe kontrollin e detergjentëve të vendosur në treg.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2025, ISHMT ka kryer në total 2445 inspektime nga të cilat 2333 inspektime të programuara dhe 112 jashtë programit mbi bazë ankese, sipas drejtorive:

- ✓ Mbikëqyrja e produkteve jo ushqimore - 1950 inspektime, nga të cilat 1909 inspektime të programuara dhe 41 inspektime jashtë programit;
- ✓ Pronësia intelektuale - 495 inspektime, nga të cilat 424 inspektime të programuara dhe 71 inspektime të paprogramuara, mbi bazë ankese.

Trupa inspektuese ka marrë 126 masa administrative në total nga të cilat 114 paralajmërime, 10 gjoba dhe 2 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar 5794 produkte nga të cilat 74 kanë qenë jo në konformitet.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Përgjatë periudhës Janar 2025 - Qershor 2025, janë ankimuar gjithsej 16 masa administrative në Komisionin e Ankimit pranë ISHMT-së, ku janë zhvilluar gjithsej 6 seanca prej të cilave:

- 8 masa administrative janë lënë në fuqi;
- 3 masa administrative është shfuqizuar;
- 5 masa administrative janë ndryshuar;

Për periudhën Qershor-Dhjetor 2025 janë paraqitur 7 ankime administrative ndaj masave administrative, pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit Administrativ në Inspektoratin e Përgjithshëm, ku janë shqyrtuar 5 ankime administrative, prej të cilave:

- 2 masa administrative janë shfuqizuar
- 3 masa administrative nuk janë shqyrtuar si pasojë e inicimit të procesit gjyqësor.

Gjatë vitit 2025 janë ndjekur në Gjykatë gjithsej 33 procese gjyqësore, nga të cilat:

- 12 kërkesëpadi është rrëzuar e subjektit ankimues;
- 1 kërkesëpadi është pranuar kundër ISHMT-së;
- 20 çështje janë në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë/Lushnjë.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": Veprimtaria inspektuese mbështetet në Programin Vjetor të inspektimeve, për vitin 2025 dhe në Programet Mujore të hartuar me listë subjektesh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuar, por jo të hartuar me bazë risku; Dokumentet standarde të inspektimit nuk janë protokolluar në mënyrë të saktë ose rezultojnë të pa protokolluara; Nuk dokumentohet marrja dijeni e subjektit, lidhur me dokumentet e veprimtarisë inspektuese mbajtur në subjekt nga grupi i inspektimit; Njoftimi i inspektimit nuk kryhet në mënyrë të saktë, nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit për kryerjen e inspektimit subjektit të inspektimit; Shkresa për njoftimin e inspektimit nuk administrohet në dosjen përkatëse të inspektimit në sistemin "e-Inspektimi"; Autorizimet lëshohen me afat joproporcional me kohëzgjatjen reale të inspektimit; Dokumenti "Listë Verifikim" nuk plotësohet saktë apo në tërësinë e saj, duke mos pasqyruar konstatimet gjatë procedurës së inspektimit, konstatohen raste kur nuk janë nënshkruar nga subjekti i inspektimit; Formati i dokumentit "Listë Verifikim" nuk është përditësuar sipas formatit standard të miratuar dhe disa pyetje janë riformuluar në përputhje me metodologjinë e riskut; Procesverbali i Inspektimit është protokolluar me vonesë të konsiderueshme nga data e kryerjes së inspektimit, si dhe nuk pasqyron në mënyrë të detajuar konstatimet apo shkeljet në subjektin e inspektuar dhe nuk detajohet baza ligjore e shkeljes; Konstatohet mospërputhje ndërmjet konstatimeve të pasqyruara në listë-verifikim, procesverbalin e inspektimit dhe arsyetimin e mbylljes së vendimit përfundimtar; Dokumenti "Vendimi Përfundimtar" është protokolluar me vonesë të konsiderueshme nga data e kryerjes së inspektimit, për inspektimet në të cilat nuk konstatohen shkelje të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit; Dokumenti "Vendimi Përfundimtar" nuk plotësohet në tërësi dhe në mënyrë të saktë; Procedura

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

inspektuese, në shumicën e rasteve, realizohet konform ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjeve sektoriale në fuqi.

Arritjet: Forcimi i kontrollit të ashensorëve-U nis zbatimi i një plani pune për garantimin e certifikimit dhe sigurisë së ashensorëve, duke forcuar bashkëpunimin me Prefektët dhe njësitë vendore për identifikimin dhe kontrollin efektiv në terren; Evidentimi i ashensorëve në spitalet publike-U realizua një inventarizim kombëtar i gjendjes teknike dhe ligjore të ashensorëve në spitalet publike, me qëllim rritjen e sigurisë dhe forcimin e përgjegjësisë institucionale; Zbatimi i qasjes së re sipas Ligjit nr. 99/2024-Në zbatim të Ligji nr. 99/2024 u aplikua paralajmërimi si masë administrative, duke promovuar qasje bashkëpunuese dhe korrigjim vullnetar të shkeljeve, përveç rasteve të rënda; Përafrimi me legjislacionin e BE për produktet e ndërtimit-Vijoi puna për harmonizimin me Rregullorja (BE) Nr. 305/2011, përmes grupit ndërinstitucional të ngritur me urdhër të përbashkët ministror; Marrëveshja me AMA kundër piraterisë-U nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi me Autoriteti i Mediave Audiovizive për krijimin e një Task-Force të përbashkët kundër piraterisë audiovizive dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit; Pjesëmarrja në Single Market Academy-ISHMT mori pjesë si Key Speaker në Single Market Academy, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve për zbatimin e rregullave të Tregut të Përbashkët dhe ACAA; Bashkëpunimi me doganat-Aksioni Pilot JCMSA-Gjatë sesionit të përbashkët me autoritetet doganore për Aksionin e 3-të Pilot JCMSA, u identifikuan 16 parregullsi në produkte elektrike dhe u theksua rëndësia e listimit të produkteve me risk të lartë; Ulja e moskonformiteteve në treg - U kryen 2,445 inspektime (2,333 të programuara dhe 112 jashtë programit). U vendosën 126 masa administrative (114 paralajmërime, 10 gjoba, 2 masa urgjente). Nga 5,794 produkte të kontrolluara, 74 rezultuan jo në konformitet; Plani i Informimit dhe Këshillimit 2025-është hartuar dhe zbatuar Plani i Informimit (qershor–dhjetor 2025), duke organizuar fushata sensibilizuese për qeset plastike dhe duke ofruar materiale këshilluese për subjektet; Rritja e transparencës dhe komunikimit publik - Publikimet e rregullta mbi aktivitetin kontrollues sollën rritje 40% të vizitorëve totalë dhe 80% të vizitorëve të rinj deri në shtator 2025; Informimi i konsumatorëve dhe operatorëve ekonomikë - Janë realizuar 10 aktivitete dhe fushata sensibilizuese për promovimin e produkteve të sigurta dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale; Trajtimi i kërkesave për informacion-Janë trajtuar 32 kërkesa për informacion, të gjitha brenda afateve ligjore, sipas Ligji nr. 119/2014; Trajtimi i 134 ankesave të ardhura përmes platformës së Bashkëqeverisjes, protokollit zyrtar të ISHMT-së, si dhe adresës elektronike info@ishmt.gov.al; Tërheqja e produkteve të rrezikshme (RASFF)-Në bashkëpunim me AKU u realizua tërheqja urgjente e dy produkteve të rrezikshme të identifikuara përmes sistemit Rapid Alert System for Food and Feed (RASFF), duke monitoruar të gjithë zinxhirin e shpërndarjes dhe siguruar bashkëpunimin e subjekteve; Hartimi i akteve të brendshme rregullatore-Janë hartuar akte për rritjen e transparencës (publikimi i dokumenteve në format të hapur), për administrimin e regjistrave të ashensorëve dhe për përmirësimin e procedurave të marrjes së informacionit mbi produktet e inspektuara; Rritja e kapaciteteve njerëzore-u realizuan 27 trajnime për stafin në fushën e mbikëqyrjes së tregut, pronësisë intelektuale dhe burimeve njerëzore, me mbështetjen e donatorëve dhe ASPA; Integrimi në

sistemin rajonal të njoftimit për produkte jo të sigurta-ISHMT u bë pjesë e sistemit të shkëmbimit të informacionit për produkte jo të sigurta të vendeve të CEFTA, me mbështetjen e GIZ; Zgjerimi i angazhimit në GPNIE-Institucioni kontribuoi në raportimet për më shumë kapituj të acquis, duke përfshirë edhe nënkapituj të rinj përveç Kapitujve 1, 7 dhe 28; Digjitalizimi i shërbimeve-certifikata e ashensorit - Vijoi bashkëpunimi me Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për ofrimin online në portalin e-Albania të shërbimit "Pajisja me Certifikatë regjistrimi të ashensorit"; Implementimi i nënshkrimit elektronik-u zbatua nënshkrimi elektronik për të gjithë inspektorët, duke rritur sigurinë dhe efikasitetin administrativ; Draft-marrëveshje bashkëpunimi institucionale - U hartuan dy draft-marrëveshje bashkëpunimi me Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë; Inspektimet për ndalimin e qeseve plastike-si pjesë e task-forcës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 35, ISHMT kreu inspektime në 1,149 subjekte për ndalimin e qeseve plastike të palejuara.

Problematikat: Mungesa në logjistikë-Mungesa e automjeteve funksionale dhe ambienteve për magazinim të produkteve të bllokuara vështirëson realizimin e inspektimeve në të gjithë territorin e vendit; Nevoja për ristrukturim dhe shtim stafi-Zgjerimi i fushëveprimit për shkak të harmonizimit me legjislacionin e BE-së dhe rritja e praktikave administrative kërkojnë ristrukturim institucional dhe shtim të burimeve njerëzore, veçanërisht juristë dhe specialistë të fushave të reja; Boshllëqe ligjore për ashensorët-Kuadri aktual, përfshirë Ligji nr. 10489/2011 dhe VKM nr. 1056/2015, nuk parashikon detyrime dhe masa administrative të qarta për instaluesit dhe mirëmbajtësit e ashensorëve, si dhe mungon procedura për ndalimin e përdorimit të tyre; Problematika me administratorët e pallateve-Mungesa e administratorëve në ndërtesat në bashkëpronësi e bën të vështirë realizimin e inspektimeve sipas procedurave ligjore për ashensorët; Nevoja për përmirësim të draftit për detergjentet-Kërkohet ekspertizë ligjore për finalizimin e ndryshimeve në Ligji nr. 10216/2010 për detergjentet; Rishikimi i kuadrit ligjor për tregtinë online-Rritja e blerjeve online kërkon ndryshime në Ligji nr. 9902/2008 për t'i dhënë ISHMT kompetencë dhe mjete për kontrollin e platformave elektronike, për të cilat aktualisht mungon infrastruktura dhe aksesi; Problematika për pajisjet e aerosolit dhe gazit-Ekzistojnë vështirësi në zbatimin e VKM nr. 925/2020 për pajisjet e aerosolit dhe projektakteve për pajisjet e gazit, që kërkojnë qartësim dhe koordinim institucional; Mungesa e akteve nënligjore për pronësinë intelektuale-Mungesa e akteve nënligjore për disa fusha të së drejtës së autorit krijon paqartësi dhe vështirësi në procedurat e inspektimit; Nevoja për trajnime dhe fushata sensibilizuese-Zgjerimi i fushave të reja (aeroplanë pa pilot, kimikate, pajisje aerosol, programe kompjuterike, etj.) kërkon trajnime të vazhdueshme dhe fushata informuese për subjektet dhe konsumatorët; Nevoja për ndryshime procedurale në analizat laboratorike-Procedurat e prokurimit për analiza në laboratorë të huaj janë të gjata dhe rrezikojnë tejkalimin e afateve ligjore për vendimmarrje; Mungesa e pajisjeve testuese (kiteve)-Nevojitet rritje e numrit të pajisjeve testuese dhe trajnime të avancuara për përdorimin e tyre gjatë inspektimeve; Digjitalizimi i regjistrimit të ashensorëve-Implementimi i regjistrimit online në e-Albania kërkon përshtatje procedurale për të lehtësuar subjektet dhe procesin administrativ; Mungesa e përditësimit të adresave në QKB-Adresat e papërditësuara dhe

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

deklarimet fiktive në QKB pengojnë realizimin e inspektimeve, pasi subjektet nuk gjenden në adresat e deklaruara.

Objektivat për vitin 2026: Rritja e përqindjes së realizimit të planit të inspektimeve; Forcimi i kontrollit dhe regjistrimit të ashensorëve në nivel kombëtar; Përmirësimi i koordinimit me njësitë vendore për administrimin e ndërtesave; Implementimi i plotë i Ligjit nr. 52/2024 për etiketimin e produkteve me ndikim në energji; Rritja e kapaciteteve teknike (pajisje testimi dhe trajnim i avancuar); Zgjerimi i shërbimeve online (certifikata e regjistrimit të ashensorit në e-Albania); Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rajonal; Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve.

4. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

4.1 Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)

ISHTI, është struktura përgjegjëse për garantimin e përmbushjes së kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sigurisë së punës së instalimeve nën presion, sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, si dhe sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë jo ushqimore, duke ushtruar veprimtarinë inspektuese në zbatim të vkm-së nr. 410, datë 13.05.2015, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".

ISHTI, realizon funksionin inspektues nëpërmjet katër drejtorive: Drejtorisë së Inspektimit të naftës e gazit dhe nënproduketeve (DINGN); Drejtorisë së inspektimit të pajisjeve nën presion (DIPNP); Drejtorisë së inspektimit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike dhe makinerive ngritëse (DIPIEMN) dhe Drejtorisë së sistemeve të gazifikimit dhe impianteve kombëtare (DSGIK).

ISHTI, kryen inspektime në fushat e inspektimit, si: Inspektimi i gazit dhe i naftës; Inspektimit i pajisjeve nën presion; Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike; Transmetim shpërndarje, tregtim, depozitim, ndërtim e operimin të infrastrukturës së gazit natyror.

Për vitin 2025, nga mbikëqyrja rezulton se ISHTI, ka planifikuar gjithsej 5,442 inspektime dhe ka realizuar gjithsej 6,406 inspektime, prej të cilave 5,723 janë të programuara dhe 683 inspektime jashtë programit.

Gjatë Janar - Dhjetor 2025, janë vendosur në total 29 masa administrative, të ndara sipas drejtorive:

- DINGN 6 masa administrative "gjobë";

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

- DIPNP 2 masa administrative "gjobë";
- DIPIEMN 21 masa administrative "gjobë";
- DSGIK- 0 masa administrative.

Gjatë periudhës Qershor-Dhjetor 2025, ndaj vendimeve përfundimtare me dënim administrativ janë paraqitur 7 ankime administrative pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit Administrativ në Inspektoratin e Përgjithshëm.

Drejtoria e Inspektimit të Naftës Gazit dhe Nënprodukteve (DINGN), kryen veprimtari inspektuese në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, duke garantuar kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës dhe gazit, si dhe nënprodukteve të tyre, për t'u siguruar konsumatorëve produkte cilësore.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025, ka realizuar në total 756 inspektime, prej të cilave 716 inspektime të programuara dhe 40 inspektime jashtë planit. Trupa inspektuese e kësaj drejtorie ka vendosur në total 6 masa administrative "gjobë".
Problematika kryesore nga inspektimi në subjektet e tregtimit dhe përpunimit të naftës dhe gazit: Mospërputhje në dokumentacionin teknik të subjekteve për instalimet dhe depozitimin e hidrokarbureve; Mosrespektim i plotë i standardeve teknike për ruajtjen dhe transportimin e naftës dhe nënprodukteve; Mangësi në dokumentimin e procedurave të mirëmbajtjes së instalimeve dhe pajisjeve të përdorura në aktivitet; Nevoja për përmirësim të kuadrit rregullator, duke kërkuar ndryshime në disa akte nënligjore që rregullojnë kushtet teknike dhe procedurat për subjektet e sektorit.

Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion (DIPNP), siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve nën presion përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 32, datë 24.03.2016, "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion".

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025, janë realizuar në total 2803 inspektime nga ku 2634 inspektime brenda planit dhe 169 inspektime jashtë planit, si dhe janë vendosur 2 masa administrative "gjobë".

Problematika kryesore nga inspektimet e realizuara në instalime dhe pajisje nën presion: Mungesë dokumentacioni për kontrollin periodik dhe certifikimin e pajisjeve nën presion; Mosrespektim i afateve të kontrollit teknik periodik për pajisje të caktuara; Mangësi në procedurat e mirëmbajtjes dhe monitorimit të sigurisë teknike të instalimeve; Nevoja për ndërgjegjësim të operatorëve ekonomikë për detyrimet ligjore që lidhen me sigurinë e pajisjeve nën presion.

Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN), siguron zbatimin e normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.**www.ip.gov.al, info@ip.gov.al**

pajisjeve elektrike përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me ligjin nr. 8734/2001, "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", i ndryshuar.

Për vitin 2025, janë realizuar në total 2840 inspektimi, ku prej të cilëve 2007 inspektime janë brenda planit dhe 473 inspektime jashtë programit, si dhe janë vendosur 21 masa administrative "gjobë".

Në këtë sektor janë identifikuar disa problematika nga inspektimi i subjekteve që lidhen kryesisht me: Mungesë ose mosplotësim i dokumentacionit teknik të pajisjeve dhe instalimeve elektrike; Mosrespektim i kërkesave të sigurisë në përdorimin e makinerive ngritëse; Mangësi në kontrollin dhe mirëmbajtjen periodike të pajisjeve elektrike dhe makinerive; Mosrespektim i plotë i standardeve teknike për funksionimin dhe sigurinë e instalimeve.

Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare, (DSGIK) ka si objekt inspektimin veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit. Objekti i inspektimeve teknike ka të bëjë me aspektet teknike të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të instalimeve dhe pajisjeve që shërbejnë për transmetimin, shpërndarjen, depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe terminalet e gazit natyror të lëngëzuar.

DSKIG, për vitin 2025, ka kryer në total 7 inspektime gjithsej, si dhe nuk ka masa administrative. Në këtë drejtori aktiviteti inspektues është më i kufizuar, për shkak të numrit të vogël të operatorëve në sektorin e gazit natyror. Problematikat kryesore lidhen me: Numër i kufizuar subjektesh aktive në sektor, ku operatori kryesor është projekti i gazsjellësit TAP; Subjekte të mbyllura ose jashtë aktivitetit, të cilat rezultojnë në sistem dhe ndikojnë në planifikimin e inspektimeve; Nevoja për rritjen e kapaciteteve teknike dhe ekspertizës në sektorin e gazit natyror.

Drejtoria e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes (DTAM)

Aktiviteti i kësaj drejtorie është fokusuar në mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi ngjarjet dhe incidentet teknike, verifikimin e shkaqeve që kanë çuar në ndodhjen e tyre, si dhe dhënien e rekomandimeve për parandalimin e aksidenteve të ngjashme në të ardhmen. Gjithashtu, drejtoria ka bashkëpunuar me drejtoritë inspektuese dhe institucionet e tjera përkatëse për ndjekjen e rasteve dhe monitorimin e zbatimit të masave të sigurisë teknike.

Në kuadër të funksioneve të saj, DTAM ka kontribuar edhe në forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe raportimit të aksidenteve, duke ndihmuar në përmirësimin e analizës së riskut dhe në rritjen e nivelit të sigurisë teknike në sektorët e mbikëqyrur nga ISHTI.DTAM është organizuar në dy sektorë kryesorë:

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

1. *Sektori i Trajtimit të Aksidenteve*, ky sektor ka si detyrë kryesore trajtimin teknik të aksidenteve të ndodhura në fushat e veprimit të drejtorive inspektuese. Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (S.T.A.), është përgjegjës për trajtimin e aksidenteve që ndodhin në fushat e mbuluara nga drejtoritë inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.
2. *Sektori i Mbikëqyrjes*, ky sektor mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e masave të sigurisë nga subjektet me risk të lartë, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin teknik dhe duke vlerësuar efektivitetin e masave parandaluese.

Gjatë periudhës Maj-Dhjetor 2025, Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (STA) ka regjistruar gjithsej 26 aksidente, të cilat kanë pasur pasoja të rënda për jetën dhe pronën. Shpërndarja e aksidenteve sipas natyrës dhe pasojave është si vijon:

- 12 aksidente kanë përfunduar tragjikisht me humbje jete të individëve;
- 2 aksidente kanë shkaktuar dëmtime fizike të qytetarëve dhe punonjësve;
- 12 aksidente kanë rezultuar në dëme materiale të konsiderueshme, në asete dhe infrastukturë.

Drejtoria Inspektuese e Pajisjeve, Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse (DIPIEMN) ka trajtuar 25 aksidente, të cilat përfshijnë aksidente të ndodhura në instalime elektrike, makineri ngritëse dhe pajisje të tjera industriale, që përbëjnë një nivel të lartë rrezikshmërie.

Drejtoria Inspektuese e Pajisjeve nën Presion (DIPNP) ka trajtuar 1 aksidente, të cilat përfshijnë ngjarje në lidhje me pajisjet që operojnë nën presion.

Laboratori i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve

Gjatë vitit 2025 në Laboratorin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve u testuan gjithsej 7324 kampione nga të cilat 3623 kampione të marra në dogana dhe 3655 kampione të marra për tregun e brendshëm, ku:

- 609 kampione janë sondazhe;
- 3010 kampione janë të plota;
- 82 kampione janë palë e tretë nga të cilat 36 kanë hyrë nga kodifikimi dhe 46 prej tyre nga zyra e protokollit.

Nga analizimi, 2 kampione, përkatësisht 1 gazoil dhe 1 white spirit, kanë rezultuar me shmangie nga standardi gjatë vitit 2025.
Gjatë këtij viti janë realizuar 19 analiza laboratorike për palë të treta, kryesisht në fushën e detergjenteve dhe bojës timbruese. Një fokus i veçantë ka qenë avancimi i procesit të akreditimit të laboratorit sipas standardit ISO/IEC 17025, përfshirë pjesëmarrjen në teste ndër-laboratorike dhe përmirësimin e dokumentacionit të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Gjithashtu, janë kryer furnizime me reagentë dhe materiale laboratorike për të garantuar vazhdimësinë dhe cilësinë e analizave laboratorike.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Arritjet: Realizimi i një numri të lartë inspektimesh - u kryen mijëra inspektime në sektorët teknikë dhe industrialë, duke garantuar mbikëqyrje të vazhdueshme dhe kontroll të aktivitetit me risk; Zbatimi i vlerësimit të riskut – u aplikua klasifikimi i subjekteve sipas nivelit të riskut për të orientuar kontrollet drejt aktiviteteve me potencial më të lartë rreziku; Monitorimi përmes sistemit elektronik - procesi i inspektimit u mbikëqyr në kohë reale nëpërmjet sistemit "e-Inspektimi", duke rritur transparencën dhe gjurmueshmërinë; Përmirësimi i dokumentimit procedurial – u rrit cilësia dhe plotësia e dokumentacionit të inspektimeve përmes verifikimit sistematik dhe kërkesave për plotësim; Vendosja e masave administrative - në rastet e shkeljeve ligjore u aplikuan gjoba dhe masa administrative për të garantuar zbatimin e legjislacionit teknik; Identifikimi i subjekteve joaktive – u evidentuan dhe u përditësuan listat me subjekte të mbyllura ose jashtë funksionit për të përmirësuar planifikimin e kontrolleve; Menaxhimi i inspektimeve jashtë planit – u sigurua reagim i shpejtë ndaj rasteve të paparashikuara përmes realizimit të inspektimeve jashtë programit vjetor; Analiza e shkeljeve dhe vendimmarrje me bazë të dhënat – u analizuan indikatorët e shkeljeve për të përmirësuar fokusin strategjik të veprimtarisë inspektuese; Përmirësimi metodologjik dhe koordinimi institucional - u avancua metodologjia e menaxhimit të riskut dhe bashkëpunimi me institucionet përkatëse për rritjen e efikasitetit të inspektimit.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": ISHTI realizon veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, "Për Inspektimet në Republikën e Shqipërisë", por me disa mangësi; Veprimtaria inspektuese e ISHTI mbështetet në Programin Vjetor të hartuar dhe miratuar nga autoriteti përgjegjës, në zbatim të VKM nr. 696/2013; Autorizim Inspektimi lëshohet me afat joproporcional me kohëzgjatjen reale të inspektimit, duke mos reflektuar proporcionalitetin dhe përcaktimin e saktë të kohëzgjatjes së veprimtarisë inspektuese, si dhe nuk njoftohet paraprakisht subjektit të inspektimit, ndërsa arsyetimi ligjor për mosnjoftimin nuk bazohet në asnjë nga rastet specifike të parashikuara në nenin 33, të ligjit për inspektimin; Shkresa për njoftimin e inspektimit nuk administrohet në dosjen përkatëse të inspektimit në sistemin "e-Inspektimi"; Trupa inspektuese e autorizuar për kryerjen e inspektimit, rezulton i përbërë vetëm nga dy inspektorë; Pyetjet e Listave të Verifikimit nuk janë riformuluar në përputhje me metodologjinë e riskut, si dhe nuk plotësohen në tërësinë e tyre, duke mos pasqyruar konstatimet gjatë procedurës së inspektimit; Procesverbal i Inspektimit nuk pasqyron në mënyrë të detajuar veprimet e kryera gjatë procedimit të inspektimit në subjekt; Vendimi Përfundimtar nuk përmban arsyetimin për mbylljen e procedurës pa shkelje të kërkesave ligjore, si dhe nuk është plotësohet në mënyrë të saktë; Vendimi përfundimtar merret përpara përfundimit të afatit ligjor për paraqitjen e kontestimeve nga ana e subjektit të inspektimit; Trupa e inspektimit nuk ka vendosur masën administrative "Paralajmërim" në inspektimin e parë, në kundërshtim me ligjin për inspektimin; Në sistemin "e-Inspektimi" nuk administrohet marrja dijeni nga subjekti i inspektimit për njoftimin e dokumenteve standarde të inspektimit; Në sistemin "e-Inspektimi" nuk gjenden të ngarkuara dokumente justifikuese të marra gjatë procesit inspektues apo dokumente të sjella nga subjekti për të cilat justifikohet heqja e shkeljes së konstatuar; Dokumentet standarde të inspektimit për inspektimet shkresore nuk janë hedhur në mënyrë të saktë në sistemin "e-Inspektimi", në modulin e inspektimeve shkresore, si dhe disa rubrika nuk janë plotësuar në tërësi.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Problematikat: Ndryshimet në kuadrin ligjor të inspektimit - hyrja në fuqi e ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" ka sjellë nevojën për përshtatje të procedurave të brendshme dhe riorganizim të disa proceseve administrative; Burimet njerëzore të kufizuara - numri i inspektorëve dhe specialistëve në disa drejtori mbetet i pamjaftueshëm në raport me numrin e subjekteve që duhen mbikëqyrur, duke ndikuar në intensitetin dhe shtrirjen e aktivitetit inspektues; Kapacitetet laboratorike të kufizuara - laboratori nuk mbulon ende të gjitha analizat e nevojshme për disa kategori produktesh dhe pajisjesh, gjë që në disa raste kërkon mbështetje nga laboratorë të tjerë ose kufizon mundësinë e verifikimit teknik të plotë; Vështirësi në ekzekutimin e masave administrative (gjobave) - një pjesë e gjobave të vendosura mbeten të paarkëtuara për shkak të ankimeve administrative dhe proceseve gjyqësore, si dhe për shkak të procedurave të gjata të ekzekutimit; Nevoja për përmirësim të koordinimit ndërinstitucional - në disa raste është evidentuar nevoja për bashkëpunim më të strukturuar me institucione të tjera përgjegjëse për sigurinë teknike, kontrollin e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit; Infrastruktura teknike dhe logjistike - pajisjet teknike dhe logjistike për inspektime në terren dhe për analizat laboratorike kanë nevojë për përmirësim dhe modernizim të mëtejshëm për të rritur efektivitetin e kontrolleve; Ndërgjegjësimi i ulët i subjekteve për detyrimet ligjore - në një pjesë të rasteve konstatohet mungesë njohurie ose zbatim i pjesshëm i kërkesave ligjore nga subjektet, çka sjell përsëritje të shkeljeve dhe kërkon më shumë angazhim në informimin dhe sensibilizimin e tyre; Numër i lartë subjektesh të mbyllura në planifikim; Përqindje e konsiderueshme inspektimesh jashtë planit (kryesisht DIPIEMN); Dokumentacion i paplotë nga subjektet në një numër të konsiderueshëm rastesh; Mosriinspektim në kohë i subjekteve me detyra korrigjuese; Ngarkesë e lartë operative në sektorët me risk teknik të shtuar.

Objektivat: Thellimi i zbatimit të inspektimit të bazuar në risk - do të përmirësohet më tej klasifikimi i subjekteve sipas riskut për të orientuar kontrollet në mënyrë më strategjike dhe efektive; Rritja e cilësisë së inspektimeve në terren - synohet forcimi i verifikimit teknik dhe dokumentimit për të garantuar standard më të lartë profesional në çdo akt inspektues; Zgjerimi i përdorimit të sistemit "e-Inspektimi" - objektiv është përdorimi i plotë dhe korrekt i sistemit elektronik për planifikim, raportim dhe monitorim në kohë reale; Forcimi i masave parandaluese dhe paralajmërimit - do të inkurajohet korrigjimi vullnetar i shkeljeve përpara aplikimit të sanksioneve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit; Reduktimi i subjekteve me shkelje të përsëritura - synohet ulja e rasteve të rikthimit në shkelje përmes ndjekjes sistematike dhe monitorimit pas inspektimit; Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional - do të forcohet koordinimi me institucionet e tjera për të shmangur mbivendosjet dhe për të rritur efektivitetin e mbikëqyrjes; Përmirësimi i analizës së të dhënave dhe treguesve të performancës - objektiv është përdorimi i analizave statistikore për planifikim më të saktë dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë; Zhvillimi profesional i stafit inspektues - do të organizohen trajnime dhe përditësime metodologjike për të rritur kapacitetet teknike dhe ligjore të inspektorëve; Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve mbi detyrimet ligjore - synohet informimi dhe orientimi i operatorëve ekonomikë për të përmirësuar përputhshmërinë me legjislacionin teknik dhe industrial.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

4.2 Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM) është institucioni përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e sigurisë në punë, menaxhimit të emergjencave dhe operacioneve të shpëtimit në veprimtarinë minerare, si dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike. Ai e shtrin aktivitetin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe funksionon si person juridik publik, buxhetor, i organizuar në nivel qendror.

Veprimtaria inspektuese e AKSEM zhvillohet në zbatim të ligjit nr. 135/2016 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike", si dhe të VKM nr. 214, datë 20.04.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera", së bashku me aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Në kuadër të përmbushjes së funksioneve të tij, AKSEM kryen inspektime në veprimtaritë minerare dhe në ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave hidroenergjetike, me qëllim verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve. Inspektimet realizohen sipas një frekuence të përcaktuar, konkretisht:

- në minierat nëntokësore me regjim gazi, jo më pak se 3 herë në vit;
- në minierat nëntokësore pa regjim gazi dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, jo më pak se 2 herë në vit;
- në minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve, jo më pak se 1 herë në vit.

Përveç veprimtarisë inspektuese, AKSEM ushtron edhe funksione të tjera mbikëqyrëse dhe teknike, si monitorimi i galerive të minierave të mbyllura ose jashtë përdorimi, vlerësimi dhe garantimi i gatishmërisë së personelit dhe mjeteve për ndërhyrje në raste emergjente, si dhe mbyllja dhe monitorimi i grykave të punimeve në minierat e braktisura. Gjithashtu, institucioni regjistron subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, vlerëson aftësitë teknike dhe profesionale të personave që përdorin lëndë plasëse ose angazhohen në shërbimet e emergjencës dhe shpëtimit, shqyrton projektet teknike për autorizimin e përdorimit civil të lëndëve plasëse, si dhe analizon dhe regjistron rastet e emergjencave dhe aksidenteve të rënda me pasoja për jetën dhe shëndetin.


Trupa inspektuese e AKSEM përbëhet aktualisht nga rreth 13 inspektorë, të gjithë me formim inxhinierik, të cilët mbulojnë këtë fushë të specializuar të inspektimit.

Gjatë vitit 2025, në sistemin "e-Inspektimi" rezulton se AKSEM ka realizuar 439 inspektime[2], nga të cilat 429 inspektim janë të programuara dhe 10 inspektime jashtë programi. Janë marrë 9 Vendime Përfundimtare Inspektimi me dënime administrative nga të cilat 3 dënime administrative

[2] Inspektime të cilat janë me statusin "Mbyllur".


Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

gjobë dhe 6 dënime administrative paralajmërim. Gjithashtu, janë marrë 3 masa urgjente me vendim të ndërmjetëm.



Në sistemin "e-Inspektimi", gjatë vitit 2025, rezultojnë 10 inspektime jashtë programi, pra rreth 2.3 % e totalit të inspektimeve të realizuara gjatë vitit.


Në mënyrë grafike arsyet e inspektimeve jashtë programi, janë sa më poshtë.



AKSEM e realizon veprimtarinë e inspektimit në subjekte të cilat janë në sipërfaqe, në nëntokë si dhe subjekte me veprimtari të kombinuar në sipërfaqe dhe nëntokë.


Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Gjatë 2025, shpërndarja e inspektimeve sipas fushës së inspektimit është si mposhtë:



Nga procesi i mbikëqyrjes rezulton se janë realizuar **138** inspektime në formë shkresore. Nga te dhënat e Analizës Vjetore të AKSEM për vitin 2025, rezulton se AKSEM nuk ka pasqyruar ende **113** inspektime të realizuara në formë shkresore. Për rrjedhojë, të dhënat mbi numrin e inspektimeve të kryera dhe rezultatet e tyre paraqiten të paplota. AKSEM duhet të marrë masat sa më parë për hedhjen e këtyre inspektimeve në sistemin "*e-Inspektimi*".

Grafiku i mëposhtëm pasqyron inspektimet e realizuara nga AKSEM, online nëpërmjet sistemit "*e-Inspektimi*" dhe në formë shkresore, brenda dhe jashtë programi.



Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Për vitin 2025, janë marrë 9 dënime administrative, nga të cilat 3 dënime administrative gjobë dhe 6 dënime administrative paralajmërim, si dhe janë marrë 3 Vendime të Ndërmjetme për marrjen e Masës Urgjente.

Përsa i përket ecurisë së masës administrative, Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave nuk ka shqyrtuar asnjë Vendim Përfundimtarë Inspektimi, me masë administrative gjobë.

AKSEM ka raportuar se ka marrë 5 masa administrative gjobë me vlerë totale 1,600,000, nga të cilat :

- 2 janë arkëtuar, derdhur vullnetarisht, në vlerën 500,000 lekë;
- 1 ekzekutuar nga përmbarimi, në vlerën 300,000 lekë;
- 2 janë në proces.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": AKSEM ka realizuar veprimtarinë inspektuese duke përdorur portalin unik "e-Inspektimi", me programe vjetore dhe mujore, si përmes aplikacionit mobile, ashtu edhe në formë shkresore, të cilat më pas janë ngarkuar në sistem. Megjithatë, nuk janë pasqyruar të gjitha inspektimet e kryera në modulët përkatës të sistemit, duke rezultuar në mungesë të dokumentimit të rreth 113 inspektimeve. Inspektimet jashtë programit shpesh nuk kanë pasur dokumentacion që justifikon arsyen e kryerjes së tyre, ndërsa në raste të tjera mungojnë të dhënat identifikuese të inspektorëve, përbërja e saktë e trupës inspektuese, kohëzgjatja e inspektimit dhe mënyra e njoftimit të subjekteve. Procesverbaleve shpesh u mungon dokumentacioni i bashkëlidhur dhe rubrikat për shpjegimet apo kontestimet e subjekteve nuk plotësohen siç duhet, përfshirë vendin e inspektimit dhe kohëzgjatjen e aktivitetit, duke shkaktuar devijime nga programi i autorizuar. Po ashtu, dokumentacioni i ngarkuar në sistem nuk është gjithmonë i saktë ose i kompletuar, duke krijuar mospërputhje me dosjet ekzistuese. Nga shqyrtimi i vendimeve përfundimtare konstatohet se disa janë marrë pa respektuar afatet për shpjegimet e subjekteve, pa përcaktuar qartë bazën e gjetjeve dhe pa dokumentuar njoftimin e tyre në sistem, duke bërë që subjekti të mos informohet si duhet. Në përfundim, pavarësisht përdorimit të sistemit elektronik dhe planifikimit të inspektimeve, evidentohet mungesë e dokumentimit të plotë dhe të saktë, gjë që ndikon në efikasitetin, transparencën dhe gjurmueshmërinë e veprimtarisë inspektuese.

Problematikat: Në disa subjekte janë shfaqur vështirësi për shkak të mungesës së fuqisë punëtore, duke çuar në mbyllje ose reduktim të aktivitetit, ndërsa numri i ulët i diplomimeve në fushën minerare ka sjellë mungesë të drejtuesve teknikë dhe specialistëve të rinj. Po ashtu, pengesat administrative për subjektet sipërfaqësore lidhur me fondin pyjor dhe kullosor, si dhe punësimi i personelit me moshë të madhe ose pa eksperiencë, ka rritur nivelin e riskut në zhvillimin e aktivitetit.

Objektivat: Për vitin 2026 janë planifikuar rreth 571 inspektime që përfshijnë subjekte nëntokësore me dhe pa regjim gazi, si dhe subjekte sipërfaqësore, me prioritet të veçantë për monitorimin e subjekteve me regjim gazi, veçanërisht Albchrome, për kontroll rigoroz dhe inspektime të

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

paplanifikuara në raste të veçanta. Drejtoria e Inspektimit, e përbërë nga 14 inspektorë inxhinierë, mbulon të gjithë territorin e vendit, duke u fokusuar në rritjen e sigurisë në miniera, monitorimin e subjekteve me risk të lartë dhe forcimin e disiplinës teknike dhe ligjore në sektorin minerar.

5. *MINISTRIA E ARSIMIT*

5.1. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)

AKAP, ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

Gjatë vitit 2025 rezultojnë 499 çështje të mbyllura, duke shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2024 (323 çështje). Aktiviteti inspektues karakterizohet nga një nivel shumë i lartë formalizimi i planifikimit, ku 97.4% e çështjeve janë të programuara dhe vetëm 2.6% jashtë programi.

Në aspektin procedural, 61.9% e çështjeve janë trajtuar përmes procedurës shkresore, ndërsa 38.1% në vend. Rritja e përdorimit të procedurës shkresore, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, evidenton nevojën për standardizim më të qartë të kritereve të përdorimit dhe raportimit të saj.

Në plan organizativ, aktiviteti inspektues paraqet një përqendrim të lartë në Drejtorinë e Përgjithshme (rreth 57.7% e totalit). Në plan sektorial, arsimi parashkollor (40.1%) dhe arsimi bazë (30.1%) përbëjnë mbi 70% të aktivitetit, duke konfirmuar këto fusha si prioritare për analizë risku dhe planifikim.

Sa i përket masave administrative, gjatë vitit janë vendosur 20 gjoba me vlerë totale 2,760,000 lekë dhe 43 paralajmërime, çka tregon një qasje të diferencuar në trajtimin e shkeljeve. Ndërkohë, janë evidentuar 41 çështje të anuluara, kryesisht për shkak të gabimeve njerëzore në regjistrimin e të dhënave.

Analiza identifikon gjithashtu problematika në cilësinë e të dhënave, përfshirë mospërputhje në numeracion, kronologji dhe mungesë të plotësimit të disa fushave në sistem. Këto çështje theksojnë nevojën për forcimin e mekanizmave të validimit dhe kontrollit në "e-Inspektimi".

Në plan procedural, janë konstatuar mangësi në dokumentimin dhe administrimin e inspektimeve, përfshirë autorizimet, protokollimin, përbërjen e grupeve të inspektimit, respektimin e afateve dhe plotësinë e akteve. Këto gjetje ndikojnë drejtpërdrejt në standardin e ligjshmërisë dhe besueshmërinë e procesit inspektues.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Në tërësi, viti 2025 shënon rritje të volumit të aktivitetit; përmirësim të planifikimit dhe formalizimit, por edhe një nevojë të qartë për standardizim procedural dhe përmirësim të cilësisë së të dhënave.

Objektivat për 2026: Forcimi i planifikimit me bazë risku; Standardizimi i përdorimit të procedurave; Zhvillim i vazhdueshëm profesional i stafeve, forcimi i llogaridhënies dhe garantimi i transparencës në vendimmarrje nga institucionet e varësisë, koordinimi i punës me DRAP/ZVAP në funksion të ofrimit dhe sigurimit të shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuadër, analiza e vitit 2025 shërben si bazë referuese për konsolidimin e reformës së inspektimit, me synim rritjen e efektivitetit, transparencës dhe qëndrueshmërisë institucionale.

6. *MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL*

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në juridiksionin e saj tre inspektorate shtetërore.

6.1 Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)

AKU është krijuar në bazë të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, "Për Ushqimin", i ndryshuar. Organizimi dhe funksionimi i institucionit është përcaktuar me VKM nr. 708, datë 09.09.2020. AKU ka nisur funksionimin më 20.05.2010 dhe ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet strukturës qendrore dhe 12 drejtorive rajonale.

Misioni i AKU-së është garantimi i sigurisë dhe cilësisë së zinxhirit ushqimor, promovimi i produkteve të sigurta dhe parandalimi i cenimit të cilësisë dhe mashtrimit me produktet ushqimore.

Inspektorati i Përgjithshëm, në ushtrim të përgjegjësisë së tij për mbikëqyrjen e ligjshmërisë, standardizimit dhe efektivitetit të veprimtarisë inspektuese, ka analizuar rezultatet e veprimtarisë së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit gjatë vitit 2025.

Viti 2025 shënoi hyrjen në fuqi të ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe hyrjen e sistemit të inspektimeve në një fazë të re konsolidimi institucional. Në këtë fazë, vlerësimi i veprimtarisë inspektuese nuk lidhet vetëm me volumin e kontrolleve të ushtruara, por edhe me cilësinë e planifikimit, gjurmueshmërinë e procedurës dhe orientimin gradual të veprimtarisë mbi bazën e riskut.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet strukturës qendrore dhe 12 drejtorive rajonale, në fusha me ndjeshmëri të lartë për interesin publik, si siguria ushqimore, ushqimi për kafshë, shëndeti i kafshëve dhe mbrojtja e bimëve. Në një institucion si AKU, cilësia e planifikimit, dokumentimit dhe


Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

gjurmueshmërisë së kontrollit lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e shëndetit publik, sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë dhe besueshmërinë e kontrollit zyrtar.

Tabela 1. Treguesit kryesorë të veprimtarisë inspektuese të AKU-së gjatë vitit 2025

Treguesi	Vlera	Lexim i shkurtër
Inspektime të realizuara gjithsej	22,776	Bazë vjetore e aktivitetit inspektues.
Inspektime brenda programit	15,021	Pesha kryesore e veprimtarisë, por me rënie të dukshme të realizimit brenda programit.
Inspektime jashtë programit	7,755	Peshë e lartë e ndërhyrjeve jashtë planifikimit.
Masa administrative	103	Ulje e ndjeshme në raport me vitet e mëparshme.
Çështje online në "e-Inspektimi"	18,529	Tregon përdorimin dominues të sistemit elektronik.
Çështje shkresore	4,247	Tregon vijimin e dokumentimit jashtë formatit të plotë elektronik.
Lista verifikimi të përditësuara	12	Progres në standardizimin e dokumentacionit.
Lista verifikimi ende të papërditësuara	3	Boshllëk që mbetet për t'u plotësuar.

Grafiku 1. Inspektimet e realizuara sipas programimit - AKU, 2025



Inspektimet jashtë programit përbëjnë rreth 34% të totalit të inspektimeve të realizuara gjatë vitit 2025.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Ky bilanc tregon se AKU ka ruajtur një volum të lartë kontrolli në një sektor me rëndësi të drejtpërdrejtë për shëndetin publik. Njëkohësisht, viti 2025 evidentoi nevojën për konsolidim të mëtejshëm të planifikimit, dokumentimit dhe orientimit të veprimtarisë inspektuese mbi bazën e riskut.

Një çështje me rëndësi lidhet me planifikimin e veprimtarisë inspektuese. Nga mbikëqyrja e ushtruar rezulton se AKU ka vijuar të punojë me më shumë se një linjë programimi, duke përfshirë programimin institucional dhe angazhime të tjera që lidhen me bashkëpunimin me strukturat e Bashkimit Evropian. Kjo qasje nuk ka garantuar në çdo rast një program të vetëm, të krahasueshëm dhe të lexueshëm. Edhe miratimi i programit vjetor dhe paraqitja e disa programeve mujore nuk kanë ndjekur gjithmonë ritmin që kërkon kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi. Në këto kushte, një pjesë e veprimtarisë është realizuar jashtë programit të miratuar.

Një çështje tjetër lidhet me përdorimin e sistemit unik elektronik "e-Inspektimi". Në tregun e brendshëm, përdorimi i sistemit ka vijuar. Në Pikat e Inspektimit Kufitar, kjo praktikë nuk është shtrirë plotësisht, ndërsa kanë mbetur në përdorim dokumente manuale dhe formularë të parashtypur. Kjo situatë ndikon në transparencën, gjurmueshmërinë e veprimeve administrative dhe mundësinë e monitorimit në kohë reale.

Gjatë vitit 2025, vështirësitë në funksionimin e sistemit "e-Inspektimi" ndikuan në dokumentimin dhe ndjekjen e njëtrajtshme të procedurës së inspektimit. Zgjidhjet e përkohshme administrative mundësuan vijimësinë e veprimtarisë inspektuese gjatë periudhës së tranzicionit. Konsolidimi i standardit kërkon dokumentim të plotë dhe të gjurmueshëm në sistemin unik elektronik.

Një element thelbësor lidhet me zbatimin e qasjes me bazë risku. AKU ka punuar për profilizimin e riskut dhe për përditësimin e listave të verifikimit, por gjatë vitit 2025 zbatimi i plotë i riskut në sistem nuk është realizuar. Në praktikë, kjo do të thotë se orientimi i inspektimeve mbi bazën e riskut mbetet ende i pjesshëm dhe kërkon konsolidim të mëtejshëm. Në një institucion si AKU, risku duhet të forcohet si kriter real planifikimi dhe prioritizimi.

Nga mbikëqyrja e ushtruar janë evidentuar gjithashtu nevoja për standardizim të mëtejshëm të disa procedurave të posaçme, përfshirë procedurat për kartën higjieno-sanitare, dokumentet shoqëruese për marrjen e mostrave dhe procedurat e asgjësimit të produkteve. Mungesa e udhëzimeve të plota, e akteve nënligjore të detajuara dhe e listave të harmonizuara ndikon në sigurinë juridike të operatorëve dhe në unifikimin e praktikës inspektuese.

Në vlerësimin e përgjithshëm, viti 2025 tregon se AKU ka ruajtur kapacitetin operacional dhe praninë në terren. Ai tregoi njëkohësisht se ruajtja e volumit të kontrollit duhet të shoqërohet me forcimin e cilësisë së planifikimit, dokumentimit, përdorimit të sistemit elektronik dhe zbatimit të vlerësimit të riskut. Në këtë kuptim, outcome kryesor i vitit 2025 lidhet me qartësimin e hapave të nevojshëm për kalimin nga sasia e kontrollit te cilësia e kontrollit.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Objektivat për vitin 2026: të sigurojë një program të vetëm, të unifikuar dhe të krahasueshëm të veprimtarisë inspektuese; të kryejë në sistemin "e-Inspektimi" të gjitha procedurat e kontrollit, përfshirë ato në Pikat e Inspektimit Kufitar; të përfundojë integrimin funksional të vlerësimit të riskut në programimin dhe realizimin e inspektimeve; të harmonizojë të gjitha listat e verifikimit me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi; të standardizojë procedurat dhe dokumentet që shoqërojnë procedurën administrative të inspektimit; të forcojë bashkëpunimin me Inspektoratin e Përgjithshëm për testimin, përmirësimin dhe zbatimin e plotë të sistemit elektronik.


6.2 *Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA)*

Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA), përmes Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit, ushtron veprimtarinë inspektuese në zbatim të ligjit nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar, si dhe VKM nr. 826, datë 28.12.2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës". Veprimtaria fokusohet në kontrollin e peshkimit detar dhe akuakulturës, duke përfshirë respektimin e distancave nga bregu, rregullsinë dhe shënjimin e veglave të peshkimit, verifikimin e ngarkesave dhe të dhënave teknike të mjeteve lundruese.

DSHPA ushtron kontroll në dy aktivitete kryesore ekonomike: peshkimi dhe akuakultura, duke garantuar zbatimin e kërkesave ligjore dhe standardeve përkatëse në këto sektorë.

Në drejtim të planifikimit, për vitin 2025 është hartuar dhe zbatuar programi vjetor i inspektimeve, në përputhje me standardet e përcaktuara nga Inspektorati i Përgjithshëm. Programet mujore janë hartuar dhe raportuar rregullisht, mbi një qasje të bazuar në risk, të ndërtuar mbi eksperiencën e strukturës inspektuese.

Gjatë vitit 2025, DSHPA ka realizuar gjithsej 735 inspektime, nga të cilat 720 inspektime të programuara dhe 15 inspektime jashtë programit, të zhvilluara si nëpërmjet sistemit elektronik "e-Inspektimi", ashtu edhe përmes dokumentacionit shkresor.



Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Në tërësi, rezulton se DSHPA ka respektuar kërkesat ligjore në fazën e programimit të inspektimeve, duke reflektuar një nivel të mirë organizimi dhe planifikimi. Megjithatë, në zbatimin e procedurës inspektuese evidentohen ende mangësi, kryesisht në drejtim të plotësimit dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm të inspektimit, të cilat tregojnë nevojën për forcimin e standardizimit të procedurave dhe përmirësimin e cilësisë së dokumentimit, me qëllim rritjen e efektivitetit, transparencës dhe qëndrueshmërisë së veprimtarisë inspektuese.

Nga Regjistri i gjobave rezulton se për vitin 2025, nga sektori i inspektimit në *DSHPA* janë vendosur 6 masa administrative gjobë, me një vlerë prej 910 000 lekë, nga të cilat njëra është ankimuar nga subjekti i inspektimit. Pas marrjes në shqyrtim nga Komisioni i Ankimit, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, masa administrative e vendosur është lënë në fuqi.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": DSHPA kryen veprimtarinë inspektuese në zbatim të legjislacionit për inspektimin, për pjesën e programimit të inspektimeve. - Në lidhje me procedurën inspektuese, evidentohen mangësi të përsëritura në dokumentimin e procedurës inspektuese, të cilat ndikojnë në gjurmueshmërinë dhe cilësinë e procesit. Këto lidhen kryesisht me mosadministrimin e plotë të dokumenteve të fillimit të procedurës, si dhe me anulimin e disa inspektimeve për arsye organizative; - Dokumentacioni i inspektimit nuk plotësohet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi; - Në procesverbalin e inspektimit nuk përshkruhen me saktësi llojet e gjetjeve të konstatuara, për të argumentuar sa më qartë masën administrative të marrë; - Në procedurën e inspektimit, të gjitha faktet dhe shkeljet e konstatuara nuk dokumentohen me dokumentacion të plotë rreth fakteve të mbledhura, gjë e cila, çon në marrje vendimi përfundimtar të pa argumentuar. - Në vendimmarrjen përfundimtare, ka mungesa ose pasaktësi në referimin e bazës ligjore të shkeljeve të konstatuara dhe masave administrative gjë e cila dobëson lidhjen juridike midis tyre dhe rrit riskun për kontestim në procedurat e ankimit.

Arritjet: Forcimi i rolit kontrollues dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë inspektuese; Është shënuar progres në rritjen e eficiencës dhe forcimin e kontrollit në sektor, duke përmirësuar organizimin e brendshëm përmes ndarjes në trupa inspektuese më funksionale. Është konsoliduar bashkëpunimi ndërinstitucional, duke krijuar marrëdhënie efektive me institucionet përkatëse në funksion të zbatimit të legjislacionit të peshkimit. Ndërmarrë ndërhyrje konkrete në ujërat e brendshme, veçanërisht në liqenin e Ohrit, për garantimin e zbatimit të urdhrave të Ministrit dhe mbështetjen e proceseve biologjike, si inkubimi i vezëve të Koranit. Evidentuar dhe parandaluar gjuetia e paligjshme, si dhe janë marrë masa administrative ndaj subjekteve në shkelje. Ushtruar kontrolle në pikat e tregtimit dhe magazinimit për parandalimin e qarkullimit të produkteve të paligjshme ose pa certifikatë origjine. Kontrolle dhe ndërhyrje realizuar në liqenet kryesore të vendit për zbatimin e

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

periudhave të ndalimit të gjuetisë, si dhe janë zhvilluar inspektime në subjektet e akuakulturës detare dhe tokësore.

Problematika: Mungesa e logjistikës për kryerjen e inspektimeve, pasi evidentohet mungesë e theksuar e mjeteve logjistike, veçanërisht mjeteve të transportit tokësor dhe ujore, të nevojshme për ushtrimin efektiv të funksioneve inspektuese. Duke qenë se një inspektor mbulon deri në 70 km vijë bregdetare, shpesh në terrene të vështira, kjo situatë kufizon ndjeshëm eficiencën e kontrolleve dhe aftësinë për evidentimin dhe parandalimin e gjuetisë së paligjshme; Organizimi i peshkimit bregdetar nëpërmjet OMP-ve, ku mungesa e dokumentacionit nga ana e mjeteve të vogla lundruese (sanalle) krijon vështirësi në pajisjen individuale me licencë peshkimi dhe në kontrollin e aktivitetit të tyre. Në këtë kontekst, organizimi i peshkimit bregdetar nëpërmjet Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP), si një praktikë e provuar me sukses në disa ujëra të brendshme të vendit, paraqitet si një zgjidhje efektive për formalizimin e aktivitetit, përmirësimin e menaxhimit dhe rritjen e nivelit të zbatimit të legjislacionit nga peshkatarët artizanalë.

Objektivat për vitin 2026: Parandalimin e paligjshmërisë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në nivel kombëtar; Garantimi i zbatimit të kritereve ligjore nga subjektet, nëpërmjet zhvillimit të inspektimeve të rregullta dhe të orientuara sipas prioriteteve të sektorit; Parandalimi dhe evidentimi i gjuetisë së paligjshme, përmes rritjes së kontrolleve në terren dhe bashkëpunimit ndërinstitucional; Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve, nëpërmjet fushatave sensibilizuese për respektimin e legjislacionit dhe ndalimin e tregtimit të specieve të ndaluara; Sigurimi i monitorimit të pandërprerë të hapësirës detare (24/7), nëpërmjet sistemit VMS dhe patrullimeve të koordinuara me strukturat përgjegjëse; Intensifikimi i kontrolleve përgjatë vijës bregdetare, me fokus në parandalimin e peshkimit të paligjshëm artizanal; Zbatimi i masave administrative ndaj subjekteve që konstatohen se shkelin legjislacionin për peshkimin; Forcimi i kontrollit në pikat e tregtimit dhe magazinimit, për të parandaluar qarkullimin e produkteve pa certifikatë origjine ose të ndaluara; Garantimi i zbatimit të urdhrave të Ministrit në ujërat e brendshme, përfshirë ndërhyrjet në liqenet kryesore të vendit për mbrojtjen e periudhave të ndalimit të gjuetisë dhe proceseve biologjike; Monitorimi dhe kontrolli i aktivitetit në laguna, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, për të siguruar zbatimin e kontratave dhe kërkesave ligjore në fushën e peshkimit dhe akuakulturës.


6.3 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)

AKZM është institucioni përgjegjës për garantimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e zonave të mbrojtura, me mision kontrollin, parandalimin dhe sanksionimin e shkeljeve që lidhen me këto zona, si dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e rrjetit të zonave të mbrojtura. Veprimtaria inspektuese organizohet në nivel qendror dhe rajonal, përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe 12 administratave rajonale.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

AKZM ushtron funksionet e saj sipas VKM nr. 570, datë 17.07.2019, i ndryshuar, ku në nivel qendror planifikon dhe koordinon veprimtarinë inspektuese, informon publikun, harton programin dhe raportin vjetor të inspektimit, si dhe kryen inspektime në subjekte me rrezik të lartë. Në nivel rajonal, administratat e zonave të mbrojtura janë përgjegjëse për ushtrimin e inspektimeve në territorin përkatës.

Për vitin 2025, AKZM ka kryer gjithsej 90 inspektime, nga të cilat 24 të programuara dhe 66 jashtë programit, si dhe ka vendosur 25 masa administrative (gjobë).



Veprimtaria inspektuese e AKZM zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, megjithëse evidentohen disa përjashtime dhe mangësi, kryesisht në dokumentimin e procedurave inspektuese.
Në lidhje me procedurat inspektuese, vijojnë të evidentohen mangësi në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.
Programi vjetor i inspektimit për vitin 2025 është hartuar sipas metodologjisë së Inspektoratit të Përgjithshëm dhe është hedhur në sistemin "e-Inspektimi", por programi vjetor nuk është hartuar mbi një analizë të mirëfilltë risku dhe nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme problematikat kryesore të fushës së mbuluar nga AKZM. Gjithashtu, programet mujore janë hartuar dhe regjistruar në sistem në mënyrë periodike, por karakterizohen nga një numër i ulët i inspektimeve të programuara, duke pasur një ndikim të kufizuar në veprimtarinë inspektuese, pasi ajo mbetet kryesisht e orientuar drejt inspektimeve jashtë programit, si dhe një numër i lartë i inspektimeve jashtë programit që përbëjnë rreth 80% të totalit të inspektimeve të kryera, çka tregon një orientim drejt veprimtarisë inspektuese të paparashikuar.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": AKZM kryen veprimtarinë inspektuese në zbatim të legjislacionit për inspektimin. – Në lidhje me programimin, orientimi i veprimtarisë inspektuese rreth 80% e inspektimeve kryhen jashtë programit, duke treguar mungesë planifikimi të bazuar në analizë risku dhe duke zhvendosur inspektimin nga funksioni

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

parandalues drejt ndërhyrjeve sporadike dhe jo sistematike. - Mangësi në dokumentimin e procedurës inspektuese si njoftimi i autorizimit, provat mbështetëse (foto, video, dokumente) dhe dokumentet që tregojnë fillimin e procedurës të cilat cënojnë gjurmueshmërinë, transparencën dhe integritetin e procesit; - Probleme me përdorimin e dokumenteve të inspektimit, listat e verifikimit, procesverbalet nuk pasqyrojnë të gjitha veprimet e kryera dhe mungon arsyetimi i konkluzioneve, formulimet e bazës ligjore janë të përgjithshme dhe pasqyrojnë jo saktë gjendjen faktike të subjektit; - Mangësi në vendimmarrjen përfundimtare, ku masat administrative nuk janë gjithmonë proporcionale me shkeljen, mungon qartësia në citimin e bazës ligjore dhe ka zbatim jo të njëtrajtshëm të nenit 44 të ligjit nr. 99/2024, që dobëson parimin e proporcionalitetit dhe ligjshmërisë.

Arritjet: Forcimi i kuadrit institucional dhe bashkëpunimit, ku është arritur një koordinim më i mirë ndërmjet AKZM-së dhe AdZM-ve në qarqe. Bashkëpunimi ndërinstitucional ka qenë efektiv edhe me strukturat ligjzbatuese si Policia e Shtetit, IKMT dhe pushteti vendor. Vënia në funksion e sistemit të inspektimeve on-line, si një risi në procesin inspektues; Përmirësim në identifikimin dhe ndështkimin e aktiviteteve të kundërligjshme; Rritje e të ardhurave nga masat administrative; Dokumentim më i strukturuar përmes regjistrave analitikë dhe sistemit elektronik; Konsolidimi i proceseve monitoruese dhe raportuese; Përmirësimi i menaxhimit të emergjencave dhe zjarreve me ulje të sipërfaqeve të përshkruara nga zjarret në krahasim me vitin 2024; Menaxhim më të qëndrueshëm të territorit dhe biodiversitetit.

Problematikat: Zbatim jo i plotë i inspektimeve on-line, procesi është implementuar, por ende ka mangësi në raportimin korrekt dhe në kohë të inspektimeve të programuara në sistemin elektronik të inspektimeve; - Cilësi e ulët e disa veprimeve inspektuese, në disa raste konstatohet qasje sipërfaqësore gjatë inspektimeve, që sjell vendime përfundimtare me mangësi procedurale dhe jo plotësisht të rregullta; - Mungesë objektiviteti dhe dokumentimi i pamjaftueshëm, pasi gjetjet nuk shoqërohen gjithmonë me informacion të detajuar dhe të argumentuar të kërkesave të ligjit nr. 99/2024; - Fokus i kufizuar në elementë të caktuar gjatë verifikimeve, pasi në rastet e subjekteve me kontrata qiraje, evidentohet kryesisht përmbushja e detyrimeve financiare, duke lënë në hije kriteret e tjera ligjore dhe mjedisore; - Kapacitete të kufizuara njerëzore dhe logjistike, me numër të vogël të trupës inspektuese, mungesa e mjeteve logjistike dhe problematika teknike të sistemit ndikojnë negativisht në cilësinë dhe shtrirjen e inspektimeve.

Objektivat për vitin 2026: Inspektime on-line dhe monitorime të aktiviteteve brenda territorit të Zonave të Mbrojtura; Monitorimi i biodiversitetit në Zona të Mbrojtura; Mbrojtja, parandalimi dhe shuarja e zjarreve në Zonat e Mbrojtura; Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i cilësisë së akteve administrative në vlerësimin e aktiviteteve të kundërligjshme në raport me kërkesat e ligjit nr.81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" i ndryshuar, dhe ligjin nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", nga trupat inspektuese; Rritja e bashkëpunimit

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

ndërinstuticional me institucionet e tjera ligjzbatuese; Rritja e perfomancës dhe aftësive profesionale; Përditësimi i regjistrit të objekteve informale.

7 *MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE*

7.1 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) ka si mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. Ai është përgjegjës për ushtrimin e të gjitha funksioneve të inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike.

ISHSH është institucion qendror, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, dhe ushtron funksionet e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.


Në zbatim të VKM nr. 241, datë 27.3.2013, "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor", ISHSH, në nivel qendror, planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit, siguron unifikimin e praktikave të inspektimit në shkallë vendi, si dhe koordinon veprimtarinë e laboratorëve duke garantuar kryerjen e analizave nga laboratorë të akreditуar. Gjithashtu, ai informon publikun për veprimtarinë inspektuese, ofron mbështetje teknike dhe administrative, përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit, si dhe kryen drejtpërdrejt inspektime ndaj subjekteve të mëdha që ushtrojnë veprimtari me rrezik të lartë.

Degët rajonale të ISHSH-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarqeve përkatëse dhe janë përgjegjëse për kryerjen e inspektimeve në nivel vendor.


ISHSH, gjatë vitit 2025, nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit *"e-Inspektimi"*, rezulton se ka realizuar 23696[3] inspektime, nga të cilat 19,488 janë të programuara dhe 4,208 jashtë programi (rreth 18%). Janë marrë 42[4] vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative gjobë, 501 vendime përfundimtare inspektimi me masa administrative paralajmërim, si dhe 24 Vendime të Ndërmjetme për Marrjen e Masës Urgjente.

[3] Inspektime të cilat janë me statusin "Mbyllur".
[4] Në sistem rezultojnë 49 dënime administrative gjobë, por 7 dënime administrative janë marrë në inspektime të realizuara test dhe për të cilat do merren masat për bërjen e tyre inaktive (të mos shfaqen).

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al




Nga të dhënat në sistemin "e-Inspektimi" rezulton se për periudhën Janar - Maj 2025 janë realizuar 10,490 inspektime online nëpërmjet sistemit "e-Inspektimi" dhe për periudhen Qershor – Dhjetor 2025 janë realizuar 13,206 inspektime shkresore.



Gjatë vitit 2024, janë realizuar në total 4208 inspektime jashtë programi, të cilat kryesisht janë realizuar me kërkesë të subjektit për pajisjen me Akt-Miratimi Higjeno- Sanitar, rreth 34 %.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Inspektimet e realizuara gjatë vitit 2025 jashtë programi, sipas arsyes përkatëse po i paraqesim në formë grafike, në përqindje.



ISHSH e realizon veprimtarinë inspektuese në *3 fusha inspektimi*:

1. Inspektime Sanitare,
2. Inspektime Shëndetësore,
3. Inspektime të tjera shëndetësore.

Gjithashtu ISHSH realizon edhe inspektime për plotësimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore ku rezulton se me kërkesë të subjektit janë bërë rreth 105 inspektime për Akreditim.
Inspektimet e realizuara për çdo fushë, paraqitet në grafikun e mëposhtëm.


Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al



Nga të dhënat e administruara në sistemin "e-Inspektimi" rezulton se gjatë vitit 2025, janë marrë masa përkatësisht:

1. 42 vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative gjobë[5].
2. 501 vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative paralajmërim.
3. 24 Vendime të Ndërmjetme për Marrjen e Masës Urgjente.

Më poshtë, pasqyrohen grafikisht dënimet administrative të marra gjatë vitit 2025.



Pranë ISHSH qendror është organizuar 1 (një) Komision Ankimi, si dhe ka përgatitur dosjet me dokumentacion përkatës për çdo subjekt ankimues:

[5] Në sistem rezultojnë 49 dënime administrative gjobë, por 7 dënime administrative janë marrë në inspektime të realizuara test dhe për të cilat do merren masat për bërjen e tyre inaktive (të mos shfaqen).

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

- 18 Masa Administrative të Shqyrtuara .
- 15 Masa Administrative të lëna në Fuqi.
- 2 Masa Administrative të Anulluara.

70 Masa Administrative me Vendim Lëshim Urdhër Ekzekutimi.
32 Masa të Ekzekutuara.
38 Masa Administrative me Vendim Lëshim Urdhër Ekzekutimi në procedurë.

34 Pagesa vullnetare në vlerë 7,504,400 Lekë.
82 Masa Total të Ekzekutuara me Vlerë 33,536,730 Lekë.

88 Procese Gjyqësore:
- 36 Fituar,
- 23 Humbur,
- 21 në procedurë

16 Procese gjyqësore në procedurë Apeli Administrativ.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": Veprimtaria inspektuese e ISHSH është zhvilluar kryesisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe përmes sistemit elektronik "e-Inspektimi", duke ndjekur planifikimin vjetor dhe mujor. Megjithatë, gjatë zbatimit janë evidentuar problematika të rëndësishme lidhur me respektimin e procedurave dhe standardeve të dokumentimit. Konstatohet mungesë dokumentimi dhe arsyetimi për inspektimet jashtë programi, autorizime të paplota ose të pasakta, përbërje jo e plotë e grupeve inspektuese dhe mospërputhje ndërmjet konstatimeve dhe dokumentimit përkatës. Në disa raste procedurat kanë nisur para miratimit formal të autorizimit, nuk është justifikuar mungesa e njoftimit paraprak ndaj subjektit, ose nuk janë respektuar afatet për dhënien e mundësisë së shpjegimeve. Po ashtu, ka pasaktësi në pasqyrimin e të dhënave ndërmjet procesverbaleve dhe sistemit elektronik, mungesë të argumentimit të gjetjeve dhe masave administrative, si dhe vendimmarrje pa garantuar të drejtën e dëgjimit të subjektit. Gjithashtu, disa vendime nuk përmbajnë afate të qarta për korrigjimin e shkeljeve dhe nuk shoqërohen me kështillim të mjaftueshëm. Në përfundim, dokumentimi i dosjeve të inspektimit nuk është gjithmonë i plotë dhe i detajuar, duke ndikuar në gjurmueshmërinë dhe transparencën e procesit inspektues.

Arritjet: Veprimtaria inspektuese është përqendruar në garantimin e kushteve higjieno-sanitare dhe respektimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë në institucionet e kujdesit shëndetësor, si në sektorin publik ashtu edhe në atë jopublik, duke përfshirë shërbimet spitalore, parësore dhe stomatologjike. Paralelisht, është ushtruar kontroll mbi institucionet arsimore me qëllim sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të sigurt për nxënësit dhe studentët. Një tjetër fokus ka qenë mbështetja për garantimin e një sezoni turistik të sigurt, përmes inspektimeve në subjektet akomoduese, strukturat e shërbimit ushqimor dhe zonat turistike. Gjithashtu, vëmendje e veçantë

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

i është kushtuar inspektimit të subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm, me synim parandalimin e sëmundjeve me origjinë hidrike. Në të njëjtën kohë, institucioni ka kontribuar në procesin e integrimit europian, si dhe në zbatimin e masave të lidhura me sigurinë në arsimin parauniversitar.

Problematikat: Mungesa e mjeteve të transportit në dispozicion të trupave inspektuese vështirëson përmbushjen e detyrave funksionale, duke ndikuar në realizimin në kohë të procedurave inspektuese sipas afateve të përcaktuara në autorizim. Njëkohësisht, problematikë mbetet edhe mosreflektimi i përditësimeve të adresave të subjekteve në QKB, çka çon në raste kur inspektimet nuk mund të realizohen, pasi subjektet nuk gjenden në adresat e deklaruara.

Objektivat për vitin 2026: Prioritetet kryesore janë përqendruar në garantimin e sigurisë së produkteve dhe shërbimeve shëndetësore, me synim mbrojtjen e shëndetit të popullatës, si dhe në përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e shëndetit publik. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar unifikimit dhe rritjes së cilësisë së veprimtarisë inspektuese në institucionet e kujdesit shëndetësor, përmes rishikimit të listave të verifikimit dhe përshtatjes së tyre me kompetencat e reja institucionale, si dhe përmes verifikimit të standardeve të cilësisë dhe akreditimit. Në të njëjtën kohë, janë zhvilluar inspektime në fusha prioritare me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin publik, si institucionet arsimore, sezoni turistik, furnizimi me ujë të pijshëm dhe zbatimi i legjislacionit për duhanin dhe alkoolin, duke u shoqëruar me monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të legjislacionit përkatës. Aktiviteti inspektues është orientuar gjithnjë e më shumë drejt qasjes së bazuar në analizën e riskut dhe përdorimit të platformës elektronike "e-Inspektimi". Paralelisht, është synuar rritja e kapaciteteve profesionale të inspektorëve përmes trajnimeve dhe edukimit në vazhdim, si dhe forcimi i transparencës dhe përmirësimi i administrimit institucional, duke kontribuar njëkohësisht në procesin e integrimit europian.

7.2 Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)

AKBPM është një institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i specializuar në analizën dhe kontrollin e barnave, dhënien e autorizimeve për tregtim, inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike, farmakovigjilencën, si dhe administrimin e standardeve për pajisjet mjekësore.

Në kuadër të funksioneve të saj, AKBPM ushtron veprimtari inspektuese pranë subjekteve farmaceutike që operojnë në vendosjen në treg dhe tregtimin me shumicë e pakicë të barnave. Kjo përfshin kontrollin e kushteve të ruajtjes së barnave, lëndëve të para dhe ndihmëse, si dhe materialeve ambalazhuese; monitorimin e tregtimit dhe eksportit të barnave të prodhuara nga fabrikuesit vendas; kontrollin e importit të barnave dhe autorizimeve përkatëse, si dhe mbikëqyrjen e pajisjeve mjekësore.

Veprimtaria inspektuese e institucionit realizohet në zbatim të ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", i ndryshuar, ligjit nr. 89/2014, "Për pajisjet mjekësore", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 24, datë 14.01.2015 "Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore", e ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je, AKBPM ka në total 99 punonjës. Sektori i inspektimit përbëhet nga 21 punonjës, nga të cilët 20 janë inspektorë dhe 1 shef sektori, të cilët mbulojnë inspektimin në fushën farmaceutike për barnat dhe pajisjet mjekësore.

Nga mbikëqyrja rezulton se, AKBPM, gjatë vitit 2025, ka realizuar 286[6] inspektime, nga të cilat 279 janë të programuara dhe 7 jashtë programi (pra rreth 2.5 %), si dhe janë marrë 10 Vendime Përfundimtare Inspektimi me dënime administrative nga të cilat, 7 dënime administrative gjobë dhe 3 dënime administrative paralajmërim.

Nga mbikëqyrja rezulton se janë realizuar **145** inspektime në formë shkresore.


Inspektimet e realizuara, jashtë programi, janë realizuar me arsyetimin "*Rast i paraqitur nga përdoruesit e barnave dhe / ose pacientet dhe / ose profesionistet e shëndetit*".



[6] Inspektime të cilat janë me statusin "Mbyllur". Në sistem figurojnë 237 inspektime të programuara dhe 49 jashtë programi, por nga 49 inspektime jashtë programi, 42 prej tyre janë realizuar me arsye "*inspektime të programuara*". Pra në total janë 279 inspektime të programuara dhe 7 jashtë programi.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

AKBPM është përgjegjëse për 5 fusha inspektimi për të cilat realizon veprimtarinë inspektuese. Gjatë vitit 2025, AKBPM ka realizuar inspektime në 4 fusha, Depo Farmaceutike, Farmaci Private, Depo e Pajisjeve Mjekësore dhe Fabrikuesit e Barnave, ndërsa në fushën Farmaci Spitalore nuk janë realizuar inspektime, pavarësisht se kjo fushë është planifikuar edhe në programin vjetor të inspektimit për vitin 2025.



Gjatë vitit 2025, janë marrë 10 dënime administrative nga të cilat 7 dënime administrative gjobë dhe 3 paralajmërim. 6 dënime administrative gjobë janë marrë në inspektime të programuara dhe 1 në inspektim jashtë programi.

Përsa i përket ecurisë së masës administrative, pranë Komisionit të Ankimit është shqyrtuar 1 (një) masë administrative, dënim me gjobë dhe në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioni ka vendosur lënien në fuqi të dënimit me gjobë.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": AKBPM zhvillon veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin per inspektimin dhe ligjet sektoriale, duke përdorur sistemin elektronik "e-Inspektimi" me tablete, program vjetor dhe programe mujore. Megjithatë, gjatë zbatimit janë evidentuar problematika të shumta lidhur me përgatitjen dhe dokumentimin e inspektimeve. Programet mujore nuk janë miratuar gjithmonë brenda afateve dhe disa inspektime janë realizuar jashtë programit pa dokumentim të arsyes. Autorizimet shpesh nuk janë plotësuar saktë, duke përfshirë objektin e inspektimit dhe miratimin për inspektimet pa njoftim paraprak. Në disa raste, listat e verifikimit dhe procesverbalet nuk janë nënshkruar siç duhet nga inspektorët ose nga përfaqësuesit e subjekteve, dhe nuk dokumentohet njoftimi i tyre. Kur subjektet gjenden të mbyllura, nuk zbatohen procedurat për afishimin e autorizimeve dhe pasqyrimin e këtij fakti në

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

procesverbal. Gjithashtu, procesverbaleve u mungon dokumentacioni i bashkëlidhur dhe ngarkimi në sistem nuk është bërë korrekt, duke shkaktuar mospërputhje me dosjet ekzistuese. Në disa raste, vendimet përfundimtare të inspektimit nuk përpunohen siç duhet, nuk njoftohen drejt ose nuk përmbajnë afate për korrigjimin e shkeljeve. Ankimet e vendimeve nuk janë trajtuar gjithmonë sipas procedurave. Në përfundim, pavarësisht përdorimit të sistemit elektronik dhe planifikimit të inspektimeve, evidentohet mungesë e dokumentimit të plotë dhe korrekt, çka ndikon në gjurmueshmërinë dhe efikasitetin e veprimtarisë inspektuese.

Objektivat për vitin 2026: Gjatë periudhës së fundit, aktiviteti inspektues ka përfshirë trajnimin e inspektorëve në bashkëpunim me Inspektoratin e Përgjithshëm për zbatimin e legjislacionit të ri gjatë tranzicionit të riorganizimit institucional. Bashkëpunimi ndërinstitucional ka qenë i zgjeruar, duke përfshirë Qendrën Kombëtare të Biznesit, Urdhrin e Farmacistëve dhe Policinë e Shtetit për identifikimin e subjekteve të pa licencuara dhe monitorimin e tregtisë online të barnave. Një fokus i veçantë i është dhënë krijimit të një baze të dhënash të përditësuar mbi subjektet farmaceutike dhe të pajisjeve mjekësore, si dhe realizimit të inspektimeve periodike dhe sezonale, me theks gjatë sezonit turistik për kontrollin e çmimeve dhe respektimin e kushteve të tregtimit. Aktiviteti ka përfshirë gjithashtu ndërgjegjësimin publik, përmes inkurajimit të raportimit të efekteve të padëshiruara, këshillimit për regjistrimin e pajisjeve mjekësore dhe edukimit mbi praktikat e ruajtjes dhe shpërndarjes së barnave. Për vitin 2026, prioritet mbetet forcimi i kapaciteteve inspektuese, zhvillimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimi i monitorimit të tregut farmaceutik, me synim garantimin e standardeve më të larta të sigurisë dhe cilësisë për qytetarët.

7.3 Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR)


ZMR ka si mision kryesor përcaktimin e kushteve për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet jonizuese dhe jo jonizuese, për të gjitha veprimtaritë që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese. Ky mision synon mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve, të popullatës dhe të mjedisit në tërësi nga rreziqet e mundshme që lidhen me rrezatimet, si dhe garantimin e sigurisë së materialeve radioaktive. Njëkohësisht, synohet shfrytëzimi maksimal i përfitimeve që vijnë nga përdorimi i rrezatimeve jonizuese, si dhe monitorimi i rrezatimeve jo jonizuese.

Gjatë vitit 2025, ZMR ka realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë, si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat, të cilat përdorin gjeneratorë me rreze X, si dhe në qendra ku ushtrohen veprimtari me burime radioaktive të hapura dhe të mbyllura. Në kuadër të këtyre inspektimeve, në varësi të objektit të inspektimit, janë kryer edhe matje të fuqisë së dozës në ambientet publike dhe në ato ku stafi është i ekspozuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues. Në bazë të këtyre matjeve është përllogaritur doza efektive vjetore për publikun dhe personelin.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Veprimtaria inspektuese është realizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar, ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jo jonizuese", i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo veprimtari është e organizuar në nivel qendror dhe shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

ZMR gjatë vitit 2025, në periudhën kohore Janar - Maj 2025, ka kryer në total 82 inspektime, nga të cilat 49 janë të programuara dhe 33 jashtë programi, pra rreth 40 % e tyre. Janë marrë 6 vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative gjobë, 43 vendime përfundimtare inspektimi me masa administrative paralajmërim.




Nga mbikëqyrja rezulton se inspektimet e realizuara në formë shkresore nuk janë pasqyruar ende në sistem, në nënmodulin përkatës. Ky proces duhej të përfundonte deri në fund të Janarit 2026, por deri në hartimin e këtij raporti, dokumentacioni nuk është ngarkuar, duke bërë që pasqyra e inspektimeve të ZMR të jetë e paplotë.

ZMR e realizon veprimtarinë inspektuese në 4 fusha inspektimi, përkatësisht:

1. Inspektimi i Burimeve Radioaktive të Hapura;
2. Inspektimi për Aparaturat me Rreze X;
3. Inspektimi për Burime të Mbyllura;
4. Inspektim për subjektet që kryejnë transport të lëndëve radioaktive.

Për vitin 2025, janë realizuar inspektime vetëm në 3 fusha inspektimit, ku numri me i madh i inspektimeve ka qenë në për Aparaturat me Rreze X, rreth 88 % e tyre.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al



Gjatë vitit 2025, janë marrë 49 masa administrative, dënim kryesor, përkatësisht:

1. 6 vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative gjobë[7];
2. 43 vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative paralajmërim.

Për vitin 2025, ZMR ka raportuar në analizën vjetore se ka realizuar 122 inspektime të programuara nga të cilat, 18 subjekte shtetërore dhe 104 subjekte private, si dhe 42 inspektime jashtë programi.

Janë marrë gjithsej 104 masa administrative kryesore të shprehura si më poshtë:

- 93 masa Dënim administrativ kryesor "Paralajmërim", dhe
- 11 masa Dënim administrativ kryesor "Gjobë".

Nuk është ankimuar asnjë nga masat administrative që kanë marrë inspektorët e ZMR- së.

Nga 11 dënime administrativ kryesor "gjobë", janë vjelë 10 prej tyre, me përjashtim të Spitalit Kavajë i cili është shkrirë, ka mbyllur NIPT dhe ka bërë bashkimin me Spitalin Universitar Shefqet Ndroqi.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": ZMR e zhvillon veprimtarinë inspektuese në përputhje me ligjin per inspektimin dhe ligjet sektoriale, duke përdorur sistemin elektronik "e-Inspektimi" me tablete, program vjetor dhe programe mujore. Megjithatë, gjatë zbatimit janë evidentuar problematika ku rezulton se, pavarësisht përdorimit të mjeteve digjitale dhe ekzistencës

[7] Gjatë vitit 2025 janë marrë edhe 2 VPI me masë administrative gjobë, për inspektime të realizuara në vitin 2024.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

së planifikimit të inspektimeve, ZMR paraqet mangësi të theksuara në zbatimin praktik të procedurave.

Konstatohen disa problematika në përdorimin e sistemit elektronik, mungesë dokumentimi dhe gjurmueshmërie, pasaktësi në autorizim dhe zhvillim të inspektimeve, si dhe mangësi në plotësimin dhe nënshkrimin e dokumentacionit. Gjithashtu, vendimmarrja përfundimtare dhe njoftimi i akteve nuk realizohen në mënyrë të plotë dhe të rregullt. Në tërësi, evidentohet nevoja për forcimin e disiplinës procedurale, përmirësimin e administrimit elektronik dhe rritjen e kontrollit të brendshëm për të garantuar cilësi dhe përputhshmëri në procesin inspektues.

Problematikat: Mungesa e pajisjeve për kryerjen e matjeve të rrezatimit jojonizues është një problematikë e mbartur ndër vite që kërkon zgjidhje. Aktualisht, sigurimi i pajisjes është në proces nga ana e ISHP dhe jemi në pritje të marrjes në dorëzim me qëllim nisjen e procesit të inspektimit.

Objektivat: Për vitin 2026, ZMR ka planifikuar kryerjen e inspektimeve në subjekte private dhe shtetërore në të gjithë vendin, ku të gjitha inspektimet do të vazhdojnë të kryhen online dhe me tableta, sipas ligjit për inspektimin dhe rifillimi i inspektimeve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jo jonizues.

8 *MINISTRIA E MJEDISIT*

8.1 Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ushtron inspektime duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

AKM ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore. AKM-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në 2 nivele: nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM).

Gjatë vitit 2025 , AKM ka realizuar *1 764* inspektime gjithsej, ku 688 inspektime online nëpërmjet sistemit "e-Inspektimi" dhe 1 076 inspektime shkresore.

Trupa inspektuese ka marrë 14 masa administrative, gjobë, dhe 88 paralajmërime.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Për vitin 2025, ndaj vendimeve përfundimtare me dënim administrativ janë paraqitur 11 ankime administrative pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit Administrativ në Inspektoratin e Përgjithshëm.

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": Procedura inspektuese, përgjithësisht, realizohet konform ligjit nr. 99/2024, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjeve sektoriale në fuqi; AKM realizon veprimtarinë inspektuese në bazë të Programit Vjetor të inspektimeve për vitin 2025, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave, për fushën e mjedisit dhe ujërave të miratuar nga autoriteti përgjegjës. Numri i inspektimeve vjetore nuk është realizuar sipas programit vjetor 2025. Programet mujore dërgohen për miratim pranë Inspektoratit të Përgjithshëm jashtë afateve ligjore të përcaktuar. Njoftimi i Autorizimit, subjektit të inspektimit nuk ngarkohet gjithmonë në sistemin "e-Inspektimi", si dhe inspektimet pa njoftim paraprak sipas shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 40, të ligjit për inspektimin, janë kryer pa marrë miratimin e Inspektoratit të Përgjithshëm. Autorizimi i Inspektimit nuk plotësohet në tërësi në përputhje me elementët e parashikuar në dokumentin standard të autorizimit të inspektimit, si dhe rezulton pa numër protokolli dhe pa datë. Grupi i inspektimit i autorizuar për kryerjen e inspektimit rezulton i përbërë vetëm nga dy inspektorë. Listë Verifikimi nuk plotësohet në mënyrë të saktë dhe në tërësinë e saj, duke mos pasqyruar konstatimet gjatë procedurës së inspektimit, si dhe është e nevojshme hartimi i një liste verifikimi e posaçme, për procedurën e "Nxjerrjes jashtë përdorimit të produkteve". Procesverbali i Inspektimit nuk pasqyron në mënyrë të detajuar veprimet e kryera gjatë procedimit të inspektimit në subjekt, si dhe pasqyron gabimisht ligjin për inspektimin në vend të legjislacionit sektorial përkatës për shkeljet e konstatuara të subjektit gjatë inspektimit apo pasqyron gabimisht ligjin për inspektimin në vend të legjislacionit sektorial përkatës për shkeljet e konstatuara të subjektit gjatë inspektimit. Nuk zbatohen dispozitat e pikave 1 dhe 2, të nenit 44, të ligjit për inspektimin, duke vendosur dy dënime administrative si kundërvajtje administrative. Vendimi Përfundimtar pasqyron gabimisht ligjin për inspektimin në vend të legjislacionit sektorial përkatës për shkeljet e konstatuara të subjektit gjatë inspektimit apo pasqyron gabimisht ligjin sektorial për vendosjen e masës administrative "paralajmërim", në vend të ligjit për inspektimin. Vendimi Përfundimtar nuk rezulton i plotësuar në tërësi, pasi në disa raste mungon citimi i numrit të procesverbalit të inspektimit, si dhe nuk përmban arsyetimin për mbylljen e procedurës pa shkelje të kërkesave ligjore ose nuk përmban arsyetim të detajuar për heqjen e shkeljes/ve së konstatuar në procesverbalin e inspektimit. Detyrat për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara lihen pa përcaktuar një afat të arsyeshëm për korrigjimin dhe eliminimin e pasojave të tyre. Nuk administrohet në sistemin "e-Inspektimi" marrja dijeni nga subjekti i inspektimit për njoftimin e dokumenteve standarde të inspektimit, si dhe nuk gjenden të ngarkuara dokumente justifikuese të marra gjatë procesit inspektues apo dokumente të sjella nga subjekti për të cilat justifikohet heqja e shkeljes së konstatuar. Dokumentet standarde të inspektimit rezultojnë të protokolluara jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizimin e inspektimit, si dhe nuk rezultojnë të nënshkruara nga përfaqësuesi i subjektit. Dokumenteve standarde të inspektimit në sistemin "e-Inspektimi", në modulin e inspektimeve shkresore nuk plotësohen saktë.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

9 *MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT*

9.1 Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB)

AKB synon zbatimin e kritereve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke inspektuar mjediset dhe dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike, si dhe duke monitoruar rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare, në kuadër të respektimit të rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare.

AKB ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", i ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore dhe nënligjore, në territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

Trupa inspektuese e AKB-së, në nivel qendror ka në përbërje 20 inspektorë, ndërsa në 4 (katër) rajonet ka nga 1 (një) specialist, të cilët nuk kryejnë inspektime.

Nga mbikëqyrja rezulton se në periudhën kohore Janar-Dhjetor 2025, AKB, Drejtoria Qendrore ka realizuar 254 inspektime gjithsej, ku prej të cilave:

- ✓ 224 inspektime për stacionet e plazhit, ku 139 inspektime të programuara dhe 85 inspektime jashtë programi;
- ✓ 3 inspektime për strukturat akomoduese, ku 2 inspektime jashtë programi dhe 1 inspektim për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga inspektimi i mëparshëm;
- ✓ 4 inspektime për operatorët detarë, ku 2 inspektime jashtë programi dhe 2 inspektime për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga inspektimi i mëparshëm;
- ✓ 4 inspektime për agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë ku 2 inspektime jashtë programi dhe 2 inspektime për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga inspektimi i mëparshëm;
- ✓ 19 inspektime jashtë programit të veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik.

Trupa inspektuese, gjatë vitit 2025, ka marrë gjithsej 102 masa administrative, nga të cilat 21 gjoba dhe 81 paralajmërime. Vlera në lekë e masave administrative, gjobë të vendosura është 5,800,000 lekë. Numri i gjobave të arkëtuara për vitin 2025 është 3 dhe vlera e tyre është 900,000 lekë.

Për vitin 2025, pranë Komisionit të Ankimit në Inspektoratin e Përgjithshëm janë depozituar dhe 8 ankime administrative.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Mbikëqyrja online nga sistemi "e-Inspektimi": AKB realizon veprimtarinë inspektuese në bazë të Programit Vjetor të Inspektimeve, të hartuar në bazë të prioriteteve dhe objektivave, dakordësuar nga Inspektorati i Përgjithshëm dhe të miratuar nga autoriteti përgjegjës. Numri i inspektimeve vjetore të planifikuara nuk është realizuar sipas programit vjetor 2025. Veprimtaria inspektuese mujore mbështetet në Programet Mujore, të hartuar me listë subjektesh inspektimi, me fushë veprimtarie të përcaktuar dhe hartuar me bazë risku, por jo për çdo muaj. Autorizimi i Inspektimit, për inspektimet e programuara, nuk njoftohet paraprakisht subjektit të inspektimit. Lista e Verifikimit nuk plotësohet në tërësinë e saj, duke mos pasqyruar konstatimet gjatë procedurës së inspektimit, si dhe nuk nënshkruhet nga subjekti. Procesverbali i Inspektimit nuk plotësohet në rubrikën "shpjegimet apo kontestimet e subjektit", duke mos përcaktuar afatin e kontestimeve të subjektit, si dhe nuk pasqyron në mënyrë të detajuar veprimet e kryera gjatë procedimit të inspektimit në subjekt. Trupa e inspektimit nuk ka vendosur masën administrative "Paralajmërim" në inspektimin e parë, në kundërshtim me ligjin për inspektimin. Vendimi Përfundimtar merret përpara përfundimit të afatit ligjor për paraqitjen e kontestimeve nga ana e subjektit të inspektimit ose përpara mbarimit të afatit të lënë subjektit për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre. Inspektimi i ri i kryer për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve kryhet pa mbaruar afati që i është lënë subjektit për korrigjimin e tyre. Inspektimet shkresore nuk janë hedhur në mënyrë të plotë dhe të saktë në sistemin "e-Inspektimi". Nuk administrohet në sistemin "e-Inspektimi" marrja dijeni nga subjekti i inspektimit për njoftimin e dokumenteve standarde të inspektimit.

Arritjet: Rritja e nivelit të përputhshmërisë ligjore - u rrit përputhshmëria ligjore e subjekteve turistike falë kombinimit të inspektimeve, monitorimeve dhe proceseve informuese nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit; Përmirësimi i standardeve në stacionet e plazhit - u përmirësuan standardet dhe siguria në stacionet e plazhit përmes kontrolleve intensive dhe ndërhyrjeve konkrete në terren; Rritja e efektivitetit të masave administrative - u rrit efektiviteti i masave administrative, duke përdorur paralajmërimet si instrument parandalues dhe gjobat për shkelje të rënda; Forcimi i bashkëpunimit institucional - u forcua bashkëpunimi institucional, duke ndihmuar në trajtimin më të shpejtë të shkeljeve dhe ankesave; Zgjerimi i rolit informues dhe parandalues - u zgjerua roli informues i institucionit, duke rritur ndërgjegjësimin e operatorëve për detyrimet ligjore.

Problematikat: Nevoja për përmirësimin e logjistikës - mungesa e mjeteve logjistike kufizoi shtrirjen dhe frekuencën e inspektimeve në terren; Mungesa e përditësimit të të dhënave të subjekteve në Qendrën Kombëtare të Biznesit - pasaktësia e të dhënave të subjekteve në QKB vështirësoi identifikimin dhe planifikimin e inspektimeve; Vështirësi procedurale në lidhje me udhërrëfyesit turistik të huaj - zbatimi praktik i dispozitave ligjore për udhërrëfyesit turistikë të huaj paraqet vështirësi, si në aspektin e regjistrimit dhe trajtimit të rasteve në sistemin "e-inspektimit", ashtu edhe në ekzekutimin e masave administrative.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Objektivat për vitin 2026: Intensifikimi dhe targetimi i inspektimeve për verifikimin e zbatimit të kritereve ligjore nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike; Garantimi i sezonit turistik përmes kontrollit të vazhdueshëm të kushteve dhe kritereve në stacionet e plazhit dhe aktivitetet e turizmit detar përgjatë zonave bregujore; Hartimi dhe aplikimi i një metodologjie të bazuar në risk për përzgjedhjen e subjekteve që do të përfshihen në planin vjetor të inspektimeve.

VI. Raportimi i veprimtarisë për inspektoratet vendore

Kjo përmbledhje pasqyron aktivitetin e inspektorateve vendorë, bazuar në të dhënat vjetore të raportuara mbi inspektimet e kryera, vendimet administrative të marra dhe masat ligjore të ndërmarra ndaj ndërtimeve të kundërligjshme.

Veprimtaria e Inspektorateve Vendore të Mbrojtjes së Territorit (IVMT) gjatë vitit 2025 është zhvilluar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi:

- ✓ Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 408/2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar;
- ✓ VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit".

Nga analizimi i raporteve vjetore rezulton një numër i lartë inspektimesh në bashkitë me aktivitet më intensiv, si: Tirana (896 kontrolle), Durrësi (303 procedura), Shkodra (214 procesverbale), Saranda (124 procesverbale) dhe Himara (108 procesverbale), ku shumica vendimeve për prishje rezultojnë të pa ekzekutuara.

- Durrës: 219 vendime për prishje, nga të cilat vetëm 31 janë ekzekutuar;
- Shkodër: 209 vendime për prishje;
- Sarandë: 115 vendime, nga të cilat vetëm 16 janë ekzekutuar;
- Dibër: 70 vendime, vetëm 3 të zbatuara;
- Krujë: 42 vendime, nga të cilat 26 mbeten të pa ekzekutuara.

Ekzekutimi i dobët i gjobave dhe i vendimeve për prishje mbetet një problem i përhapur. Shumë bashki raportojnë vendime të marra, por jo të zbatuara, kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve, kapaciteteve njerëzore dhe pengesave që lidhen me proceset gjyqësore.

Sa i përket kallëzimeve penale, disa nga bashkitë me numrin më të lartë janë:

- Durrës: 67 kallëzime;
- Sarandë: 66 kallëzime;

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

- Vau i Dejës: 27 kallëzime;
- Shijak: 15 kallëzime.

Gjithashtu, evidentohet se shumica e gjobave të vendosura nuk arkëtohen, çka tregon nevojën për forcimin e mekanizmave të ekzekutimit dhe mbledhjes së detyrimeve.

Për më tepër, vendimet për prishje shpesh mbeten të pazbatuara për shkak të mungesës së mjeteve të rënda dhe kapaciteteve logjistike. Në shumë raste, këto vendime kundërshtohen në gjykatë ose mbeten në proces shqyrtimi, duke vonuar ekzekutimin e tyre.

Në përfundim, raporti evidenton një aktivitet të gjerë inspektues në nivel kombëtar, por me efikasitet të kufizuar në zbatimin e vendimeve dhe problemet kryesore lidhen me:

- Mosarkëtimin e gjobave;
- Moszbatimin e vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme;
- Kapacitetet e pamjaftueshme teknike dhe njerëzore.

Nga ky analizim sugjerojmë nevojën për:

- Rritjen e transparencës mbi ecurinë e ekzekutimit të gjobave;
- Investime në mjete dhe kapacitete për realizimin efektiv të prishjeve.

VII. Raport Monitorimi i Buxhetit për vitin 2025 për Inspektoratin i Përgjithshëm

Në zbatim të ligjit nr. 115/ 2024, "Për buxhetin e vitit 2025", si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Inspektoratit të Përgjithshëm (IP) i është miratuar plani i buxhetit prej 53 941 000 lekë, i detajuar si më poshtë vijon:

Në /lekë

Llog.ekonomike	**Përshkrimi**	**Plan 2025**
llog. 600	Paga	32 534 000
llog. 601	Sig.shoq punëdhënës	5 307 000
llog. 602	Shpenzime operative	13 000 000

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

llog. 606	Ndihma ekonomike	100 000
llog. 231	Shpenzime kapitale	3 000 000
	TOTALI	**53 941 000**

Gjatë vitit 2025, Inspektorati i Përgjithshëm ka patur rishikim të planit të buxhetit për vitin 2025, me Aktin Normativ nr. 6 datë 11.06.2025, "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", në zbatim të ligjit të ri nr. 99/2024, "Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë", VKM-së nr. 330/2025, "Për krijimin e Inspektoratit të Përgjithshëm", i detajuar si më poshtë vijon:

Llog.ekonomike	**Përshkrimi**	**Plan 2025 I**
llog. 600	Paga	82 534 000
llog. 601	Sig.shoq punëdhënës	5 307 000
llog. 602	Shpenzime operative	28 000 000
llog. 606	Ndihma ekonomike	100 000
llog. 231	Shpenzime kapitale	8 000 000
	TOTALI	**123 941 000**

Me Aktin Normativ nr. 6 datë 11.06.2025, "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/ 2024 "Për buxhetin e vitit 2025", kemi shtesë fondi në:

a) shpenzime për paga, llog.ekonomike 600, prej 50 000 000 lekë, si rrjedhojë e rritjes së stafit me 77 punonjës;
b) shpenzime operative, llog. ekonomike 602, prej 15 000 000 lekë, si rrjedhojë e marrjes së një ambienti me qira për krijimin e kushteve të punës për stafin e ri prej 98 punonjës të Inspektoratit të Përgjithshëm.
c) shpenzime kapitale, llog. ekonomike 231, prej 5 000 000 lekë, për blerje pajisje zyre mobilje për 77 punonjësit e rinj.

Me Aktin Normativ nr. 11 datë 19.12.2025, "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/ 2024, "Për buxhetin e vitit 2025", kemi shtesë fondi llog 231, prej 9 340 000 lekë, për blerje pajisje informatike.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Llog.ekonomike	Përshkrimi	Plan 2025 I
llog. 600	Paga	82 534 000
llog. 601	Sig.shoq punëdhënës	5 307 000
llog. 602	Shpenzime operative	28 000 000
llog. 606	Ndihma ekonomike	100 000
llog. 231	Shpenzime kapitale	17 340 000
	TOTALI	**133 281 000**

Gjatë vitit 2025, IP ka realizuar buxhetin në vlerën ***66 598 770 lekë*** nga totali i akorduar prej ***133 281 000 lekë*** ose **49.9 %** të fondit të planifikuar, të rishikuar, vjetor 2025, detajuar **sipas tabelës më poshtë:**

Në /lekë

Llog.ekonomike	përshkrimi	Buxheti Vjetor Plani I rishikuar i Vitit 2025	Fakti progresiv 12 mujori 2025	Realizimi buxhetor 12 mujori 2025 në %
llog. 600	Paga	82 534 000	30 263 379	36.6 %
llog. 601	Sig.shoq punëdhënës	5 307 000	4 798 406	90.4 %
llog. 602	Shpenzime operative	28 000 000	24 164 441	86.3 %
llog. 606	Ndihma ekonomike	100 000	68 600	68.6 %
llog. 231	Shpenzime kapitale	17 340 000	7 303 944	42.1 %
	TOTALI	**133 281 000**	**66 598 770**	**49.9 %**

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore Punëdhënës (llog. 600-601), deri në datën 31.12.2025, është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me urdhër të Kryeministrit nr.144, datë 02.09.2025 "Për miratimin e strukturës dhe organikës të Inspektoratit të Përgjithshëm", me 34 punonjës, nga numri gjithsej prej 98 puonjësish.

Për sa më sipër gjatë vitit 2025 u realizua sa më poshtë:

- ✓ Fondi i pagave (llog. 600), i akorduar prej **82 534 000 lekë,** (me rishikimin e buxhetit), për vitin 2025, është reaalizuar në vlerën **30 263 379 lekë,** ose në masën 36.6 %;

- ✓ Fondi i Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore Punëdhënës (llog. 601), i akorduar prej **5 307 000 lekë**, për vitin 2025, është realizuar në vlerën **4 798 406 lekë,** ose në masën 90.4 %.

Fondi për shpenzime operative dhe Ndihma ekonomike (llog. 602, 606), është realizuar në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025".

- ✓ Plani i buxhetit të vitit 2025, i rishikuar, për shpenzime operative (llog.602) është **28 000 000 lekë** dhe për vitit 2025, është realizuar **24 164 441 lekë** ose në masën 86.3%;

- ✓ Plani i buxhetit të vitit 2025 për Ndihma ekonomike (llog. Ekonomike 606) është **100 000 lekë** dhe për vitin 2025, është realizuar në vlerën **68 600 lekë**, ose në masën 68.6%.

Fondi për shpenzime kapitale (llog. ekonomike 231). Për vitin 2025, plani i buxhetit për shpenzime kapitale, të trupëzuara, me financim të brendshëm, është akorduar në vlerën **3 000 000 lekë**, dhe me Aktin Normativ nr. 6 datë 11.06.2025, "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/ 2024 "Për buxhetin e vitit 2025", fondi për shpenzime kapitale u shtua me 5 000 000 lekë, pra fondi për shpenzime kapitale është 8 000 000 lekë.

Fondi **3 000 000** lekë akorduar për blerje pajisje hardëere, (tableta, kompjuter), me kod projekti 18AO601, për inspektime online për Inspektoratet Shtetërore dhe kompjuter për zyra. Ky fond i akorduar për "Blerje pajisje hardëere ", është realizuar në vlerën 589 176 lekë për blerje kompjuter, dhe pjesa tjetër e fondit u prokurua nga AKSHI gjatë vitit 2025, sipas specifikimeve të publikuara dhe miratuara në vlerën 2 337 000 lekë. Totali i realizimit për këtë zë është në vlerën 2 926 176 lekë.

Fondi **5 000 000** lekë akorduar për blerje pajisje zyre, (tavolina, dollap, karrige), me kod projekti M870015, për 77 punonjësit e rinj për Inspektoratin e Përgjithshëm. Procedura e prokurimit u realizua nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara (OBP), gjatë vitit 2025, sipas specifikimeve të publikuara dhe miratuara në vlerën 3 539 520 lekë. Pjesa tjetër e fondit u prokurua me procedurën

e prokurimit me vlera të vogla me objekt "Blerje Karrige për Zyra", procedurë e cila u realizua në vlerën 838 248 lekë. Totali i realizimit për këtë zë është në vlerën 4 377 768 lekë.

Vlera e alokuar në masen 9 340 000 lekë nuk u realizua pasi procedura nga AKSHI u zhvillua për vitin buxhetor 2026.

Në realizimin e zërave buxhetore të planifikuar për Vitin 2025, IP-ja ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 99 datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit".

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

VIII. KONKLUZIONE

Inspektorati i Përgjithshëm, me të gjitha parashtrimet e mësipërme konkludon se procesi inspektues ka përmirësime të kënaqshme, të cilat lidhen me miratimin e ligjit të ri të inspektimit, me kryerjen e inspektimeve online, duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në marrjen e vendimeve përfundimtare të inspektimit, si dhe duke ulur barrën administrative ndaj biznesit.

Për sa më sipër në këtë raport konkludojmë se:

- ✓ Ligji i ri për inspektimin nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", hyri në fuqi më 13.05.2025 dhe ka vendos një kuadër rregullator dhe horizontal për të gjitha inspektoratet qendrore dhe vendore që ndodhen nën fushëzbatimin e tij. Ky ligj normon procedurat e inspektimit, rekrutimin dhe disiplinën e inspektorëve, si dhe ankimin administrativ, duke synuar unifikimin e veprimtarisë së sistemit të inspektimeve dhe përmirësimin e klimës ndaj biznesit.
- ✓ Vazhdon të evidentohet mungesë e vullnetit institucional për realizimin e inspektimeve online nëpërmjet sistemit "e-Inspektimi", ku kjo problematikë konstatohet veçanërisht në veprimtarinë inspektuese të zhvilluar në pikat e kalimit kufitar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), në inspektimet në fushën e territorit dhe planifikimit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), si dhe në inspektimet në fushën e veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB).
- ✓ Mosmiratimi i planit vjetor të inspektimit nga ministri i linjës brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin për inspektimin, ndikon negativisht në planifikimin dhe zbatimin në kohë të veprimtarisë inspektuese.
- ✓ Mosrealizimi i veprimtarisë inspektuese në të gjitha rastet nëpërmjet përdorimit të tabletave dhe aplikacinoit mobile, nga trupat inspektues, në përputhje me kërkesat e sistemit "e-Inspektimi", çka ndikon në moszbatimin e plotë të procesit të digjitalizimit të inspektimeve.
- ✓ Mospërputhja ndërmjet programeve të miratuara të inspektimit dhe atyre të gjeneruara në sistem, duke sjellë si pasojë mosrealizimin e numrit të inspektimeve të planifikuara sipas programit vjetor. Edhe kjo çështje është evidentuar si problematikë e përsëritur nga raportimet e mëparshme.
- ✓ 16 inspektorate shtetërore realizojnë veprimtarinë inspektuese online nëpërmjet portalit unik *"e-Inspektimi"*, sipas ligjeve nr. 10433/2011 dhe 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", vkm nr. 696/2013, "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik *"e-Inspektimi"*, ligjeve sektoriale, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi që rregullojnë fushat e inspektimit.
- ✓ Dokumentet standarde të inspektimit si: Autorizim, listë-verifikimi, procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar kanë mangësi në plotësimin e tyre dhe në disa raste nuk ka shpjegime të detajuara për gjetjet e konstatuara.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

- ✓ Disa prej inspektorateve vazhdojnë të mos përditësojnë përsëri listë-verifikimet sipas formatit standard të miratuar nga IQ, sipas Urdhrit nr. 25, datë 10.08.2018, "Për miratimin e Rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ", i ndryshuar, e cila ndikoi edhe në mos funksionimin e modulit të riskut.
- ✓ Regjistri Kombëtar i inspektorëve shtetërorë është mbajtur dhe përditësuar sipas Kreut V, të vkm nr. 696, datë 16.08.2013, "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik *"e-Inspektimi"*.

IX. REKOMANDIME

Inspektorati i Përgjithshëm, në funksion të përmirësimit të efektivitetit, transparencës dhe përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë inspektuese, për vitin 2026 rekomandon një sërë masash të integruara në nivel organizativ dhe operacional, sa vijon:

- ✓ Dhënia e mendimit dhe kontributit teknik për hartimin e projektakteve nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe organizimin e inspektorateve qendrore, në kuadër të riorganizimit të tyre në zbatim të VKM nr. 408, datë 16.7.2025, "Për përcaktimin e institucioneve që riorganizohen sipas ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", duke i shoqëruar këto akte me paketat përkatëse ligjore.

- ✓ Përgatitja e materialeve analitike dhe zhvillimi i proceseve të konsultimit për hartimin e projektakteve nënligjore të cilat janë në proces, duke përfshirë projektvendimet, raportet e vlerësimit të ndikimit, raportet e konsultimeve dhe relacionet shpjeguese, si dhe paraqitja e tyre për vendimmarrje pranë organeve kompetente.

- ✓ Orientimin e trupave inspektuese drejt një qasjeje këshilluese dhe parandaluese ndaj subjekteve të inspektimit, në përputhje me parimet dhe frymën e ligjit të ri për inspektimin.

- ✓ Përdorimi i sistemit "e-Inspektimi", si platformë e vetme për planifikimin, realizimin dhe administrimin e inspektimeve në të gjithë sektorët, duke vënë në funksion përdorimin efektiv të modulit të riskut për planifikimin e veprimtarisë inspektuese mbi bazë risku programet vjetore/mujore, përdorimin e tabletës në terren dhe aktivizimin e elementëve të gjurmueshmërisë si GPS.

- ✓ Mbështetje metodologjike për të gjitha inspektoratet qendrore/vendore, me qëllim përshtatjen e dokumenteve standarde dhe përditësimin e listë-verifikimeve në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 99/2024 dhe akteve të tjera nënligjore.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

- ✓ Forcimi i rolit mbikëqyrës për monitorimin e veprimtarisë inspektuese të inspektorateve qendrore/vendore, me qëllim sigurimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi në fushën e inspektimit.

- ✓ Njoftimi i inspektimit në përputhje me kërkesat ligjore, përmes njoftimit paraprak të autorizimit dhe regjistrimit të tij në sistem, si dhe të shmanget përdorimi i pajustifikuar i inspektimeve pa njoftim dhe të garantohet dokumentimi i plotë i komunikimit me subjektin.
- ✓ Dokumentet standarde të inspektimit si: Autorizimi, Lista e Verifikimit, Procesverbali dhe Vendimi Përfundimtar të plotësohen në mënyrë të saktë, të plotë dhe të argumentuar, duke reflektuar qartë gjetjet, veprimet dhe vendimmarrjen gjatë procesit.
- ✓ Listat e Verifikimit të përditësohen sipas formatit standard dhe të bazohen në metodologjinë e vlerësimit të riskut.
- ✓ Nënshkrimi dhe vlefshmëria e dokumenteve duhet të garantohet nga trupa inspektuese. ose të argumentohet mungesa e nënshkrimeve.
- ✓ Dokumentacioni mbështetës i mbledhur gjatë inspektimit duhet të administrohet në mënyrë të plotë në sistemin "e-Inspektimi".
- ✓ Trajtimi me prioritet, në kohë dhe me cilësi i kërkesave dhe ankesave, si dhe rritja e transparencës së procesit inspektues për të forcuar besueshmërinë e publikut dhe për të përmirësuar marrëdhëniet e partneritetit me biznesin.
- ✓ Të hartohen dhe miratohen procedura të veçanta të standardizuara për fusha specifike, duke përfshirë licencimin, pajisjen me Akt-Miratim Higjieno-Sanitar, trajtimin e produkteve për asgjësim, si dhe procesin e marrjes së mostrave për analizë. Këto procedura duhet të shoqërohen me lista verifikimi dhe dokumentacion të dedikuar, duke garantuar ndarje të qartë ndërmjet proceseve të inspektimit dhe monitorimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

- ✓ Të vazhdojë bashkëpunimi dhe mbështetja për përdorimin e sistemit unik elektronik "e-Inspektimi", për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për fushën e ndërtimit dhe për Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të cilët akoma nuk kryejnë inspektime online.

- ✓ Të vazhdojë procesi informues sa më shumë të jetë e mundur nga ana e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe Inspektorateve Qendrore për biznesin dhe qytetarët mbi ligjin e ri të inspektimit nr. 99/2024, për të qenë transparent dhe efektiv lidhur me detyrimet mbi zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

X. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026

Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet planit të tij vjetor të punës për vitin 2026, ka përcaktuar objektivat e tij , ku synon forcimin e një sistemi inspektimi modern, të unifikuar dhe të orientuar nga risku, duke rritur transparencën, efikasitetin dhe cilësinë e veprimtarisë inspektuese, si dhe duke kontribuar në uljen e barrës administrative për biznesin dhe rritjen e besimit të publikut.

Këto objektiva konsistojnë në:

- ✓ **Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator**

  Të kontribuohet në hartimin dhe harmonizimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 99/2024, përmes përgatitjes së projektakteve, materialeve analitike, raporteve të vlerësimit të ndikimit dhe dokumentacionit shoqërues për vendimmarrje.

- ✓ **Orientimi drejt qasjes parandaluese dhe këshilluese**

  Të orientohet veprimtaria e trupave inspektuese drejt këshillimit dhe parandalimit të shkeljeve, në përputhje me parimet e ligjit të ri për inspektimin.

- ✓ **Zhvillimi dhe optimizimi i sistemit "e-Inspektimi"**

  Të përmirësohet funksionaliteti i sistemit elektronik "e-Inspektimi", duke përfshirë analizimin e kërkesave ligjore dhe teknike, hartimin e propozimeve konkrete për zhvillim dhe miratimin e akteve përkatëse për funksionimin e tij.

- ✓ **Zbatimi i planifikimit me bazë risku**

  Të vihet në funksion të plotë moduli i riskut dhe të sigurohet që planifikimi i inspektimeve të kryhet mbi bazën e vlerësimit të riskut, në të gjitha inspektoratet shtetërore.

- ✓ **Konsolidimi i sistemit të unifikuar të inspektimeve**

  Të standardizohen procedurat, dokumentet dhe listat e verifikimit, duke garantuar përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe eliminimin e praktikave të ndryshme ndërinstitucionale.

- ✓ **Harmonizimi i legjislacionit sektorial**

  Të sigurohet përshtatja e akteve sektoriale me kuadrin e ri ligjor, duke reduktuar mbivendosjet e kompetencave dhe duke unifikuar procedurat e inspektimit.

- ✓ **Forcimi i koordinimit ndërinstitucional**

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al

Të rritet bashkërendimi ndërmjet inspektorateve qendrore dhe vendore, përmes koordinimit të planeve mujore dhe realizimit të inspektimeve të përbashkëta.

- ✓ **Zgjerimi i digjitalizimit të procesit inspektues**

  Të sigurohet përdorimi i detyrueshëm i sistemit "e-Inspektimi" dhe zhvillimi i inspektimeve online, përfshirë pajisjen e strukturave me infrastrukturën e nevojshme teknologjike.

- ✓ **Rritja e kapaciteteve profesionale të inspektorëve**

  Të zhvillohen programe trajnimi dhe testimi për inspektorët në detyrë, me fokus në profesionalizëm, integritet dhe zbatimin e metodologjisë së riskut.

- ✓ **Ndërtimi i sistemit të trajnimit dhe certifikimit**

  Të krijohet një kurrikulë e standardizuar për formimin dhe certifikimin profesional të inspektorëve, në përputhje me kërkesat e funksionit rregullator.

- ✓ **Forcimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm**

  Të përmirësohet mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese për të garantuar zbatimin korrekt të legjislacionit dhe rritjen e cilësisë së vendimmarrjes.

- ✓ **Përmirësimi i menaxhimit dhe analizës së të dhënave**

  Të zhvillohet administrimi dhe analiza e të dhënave statistikore përmes sistemit "e-Inspektimi", në funksion të politikëbërjes dhe rritjes së performancës.

- ✓ **Përmirësimi i menaxhimit të ankesave dhe kërkesave**

  Të sigurohet trajtimi në kohë, me cilësi dhe në mënyrë të strukturuar i ankesave dhe kërkesave të subjekteve dhe qytetarëve.

- ✓ **Rritja e transparencës dhe besimit publik**

  Të forcohet komunikimi institucional dhe transparenca e procesit inspektues, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe ndërtimin e një marrëdhënieje bashkëpunuese me biznesin.

Rruga: "Nuredin Llagami", Objekti MD, Kompleksi Deliorgji, Kulla e zyrave të reja, 1001, Tiranë.www.ip.gov.al, info@ip.gov.al